



**National Business Forum**



**AXHENDA KOMBËTARE E BIZNESIT  
PËR  
SHQIPËRINË**

Prill, 2017

## **FALENDERIMET**

Axhenda Kombëtare e Biznesit (NBA) është një iniciativë shqiptare dhe një mjet për të komunikuar në një mënyrë të hapur, konstruktive dhe profesionale me qeverinë mbi prioritetet e komunitetit të biznesit në Shqipëri. Ky mjet është rezultat i punës së anëtarëve të Forumit Kombëtar të Biznesit (NBF), ku gjejmë mundësinë të falënderojmë të gjithë për kontributin e dhënë.

Në përgatitjen e këtij dokumenti u dha një mbështetje e madhe dhe kontribut i vyer nga më shumë se 100 organizata rajonale biznesi, anëtarë të NBF dhe ekspertë të angazhuar për finalizimin e suksesshëm të tij. Një falenderim i thellë shkon për të gjithë ata që dhanë ndihmën e tyre në përgatitjen e këtij instrumenti. NBF vlerëson mendimet, komentet dhe kontributet e pjesëmarrësve në Konferencën Kombëtare dedikuar lançimit të NBA, organizuar në Tiranë më 28 Mars, 2017.

NBA u hartua përmes kontributit të përbashkët të një ekipi të përkushtuar të kolegëve të mi në ACER, përfshirë Zyhrada Kongoli dhe Aida Bushati (Gugu) –Ekspertë Ligjore për Çështjet e Biznesit, Floreta Drinziu- Eksperte e Politikave Fiskale, Brunilda Kosta- Eksperte për Çështjet e Biznesit dhe me asistencën e Carmen Stanila dhe Camelia Bulat, konsulentë të CIPE.

Mirënjohje të thella shkojnë për CIPE, për mbështetjen teknike dhe atë financiare të ofruar për përfundimin me sukses të kësaj fazës të këtij programi. Falenderoj në mënyrë të veçantë Martina Hrvolova, Oficeren e Programit në CIPE për dedikimin e saj në këtë projekt dhe për kontributin në dhënien e komenteve, sugjerimeve dhe inputeve shumë të dobishme gjatë gjithë procesit të zhvillimit të NBA.

Një falenderim i veçantë shkon për Natalia Otel Belan, Zëvendës Drejtor Rajonal për Euroazinë dhe Marc Schleifer, Drejtor Rajonal për Euroazinë, për inicimin e këtij programi në Shqipëri.

Gjej mundësinë për të falënderuar të gjithë zyrtarët publikë dhe komunitetin e biznesit që ofruan kohën, mendimet dhe kontributet e tyre për finalizimin e NBA.

***Dr. Zef Preci***

***Drejtor Ekzekutiv, ACER***

## **E DREJTA E AUTORIT**

Axhenda Kombëtare e Biznesit për Shqipërinë reflekton pikëpamjet e komunitetit të biznesit, të cilët morën pjesë në Forumet Rajonale të Biznesit (RBF) gjatë verës së 2016 dhe liderëve të organizatave të biznesit që morën pjesë në takimin e mbajtur në Tiranë më 28 Mars, 2017. Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura, nuk reflektojnë pikëpamjet e CIPE. Roli kryesor i CIPE në procesin e finalizimit të NBA ishte asistimi i komunitetit shqiptar të biznesit me organizimin e nismës, hartimin dhe prodhimin e raportit final.



# National Business Forum

NBA është përgatitur nga Forumi Kombëtar i Biznesit. NBF një rrjet i hapur i Shoqatave të Biznesit, Dhomave të Tregtisë dhe Organizatave të tjera në mbështetje të biznesit i cili është lançuar më 22 Nëntor, 2013 dhe është themeluar nga 9 organizata. Anëtarët e NBF nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi dhe pranuan të punojnë së bashku mbi çështje të interesit të përbashkët nën strukturën e NBF. Misioni i NBF është të përfaqësojë interesat e bizneseve që operojnë në Shqipëri në dialog me institucionet publike. Anëtarët themelues të NBF janë: Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (ACER), Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (ACA), Dhoma Shqiptare e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Zhvillimit (ACITAD), Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë (CCI), Shoqata e Konvertuesve të Plastikës së Shqipërisë (APKA), Shoqata e Grave Profesioniste, Afariste e Zejtare të Shqipërisë (SHGPAZ), Shoqata Shqiptare e Riciklimit (ARA), Shoqata e Konvertuesve të Plastikës së Shqipërisë (APKA), Dhoma Shqiptare e Fasonit (FCA) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA). Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AMCHAM) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) janë partnerët e këtij Forumi.

Website: [www.nbf.al](http://www.nbf.al)



Ky dokument është përgatitur me mbështetjen e Qendrës Ndërkombëtare për Sipërmarrje Private (CIPE), në kuadër të programit ‘‘Shqipëria: Ndërtimi i një dialogu efektiv publik-privat’’. CIPE ka si mision fuqizimin e demokracisë përmes sipërmarrjeve private dhe reformave të orientuara drejtë tregut. CIPE është një nga institutet kryesore të Ndhmës Kombëtare për Demokraci (NED) dhe Dhomës Amerikane të Tregëtisë. CIPE ka më shumë se 30 vite eksperiencë dhe ka kryer më shumë se 1.300 programe reformash në më shumë se 100 shtete të botës. Fushat kryesore të programit përfshijnë ekosistemet e sipërmarrjes, qeverisja demokratike, përkrahjen e biznesit, anti-korrupsionin dhe etikën.

Website: [www.cipe.org](http://www.cipe.org)

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>LISTA E SHKURTIMEVE .....</b>	<b>5</b>
<b>PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>10</b>
<b>1. METODOLOGJIA .....</b>	<b>12</b>
<b>2. PRIORITETET E FORUMIT KOMBËTAR TË BIZNESIT PËR VITIN 2017 .....</b>	<b>13</b>
<b>2.1. KONTROLLI TATIMOR.....</b>	<b>13</b>
A. Mosfunksionimi i plotë i sistemit të përzgjedhjes në bazë të riskut .....	13
B. Mos zbatim i të drejtës së informimit dhe të njoftimit të tatimpaguesve .....	17
C. Moszbatueshmëri e së drejtës për kontrole të arsyeshme .....	18
D. Dënime administrative të pamotivuara .....	18
E. Sistemi i prezantuar rishtazi ka krijuar disa probleme .....	19
F. Niveli etik dhe profesional i inspektorëve tatimore.....	19
<b>2.2 SEKTORIALIZIMI I TVSH .....</b>	<b>21</b>
A. Tvsh në sektorin e përpunimit aktiv (industria fasonit) .....	21
B. Tvsh në sektorin bujqësor .....	23
C. Tvsh në sektorin e turizmit.....	25
<b>2.3 INFORMALITETI.....</b>	<b>27</b>
A. Aksionet e qeverisë kundër informalitetit .....	27
B. Ndarja e tatimit mbi fitimin në sistemin tatimor .....	29
C. Ndarja e TVSH-së në Shqipëri.....	30
D. Kostot e larta të biznesit.....	30
E. Paqëndrueshmëria dhe cilësia e legjislacionit .....	32
F. Mungesa e shërbimeve publike për taksat që paguhen.....	33
G. Besimi i ulët i komunitetit të biznesit ndaj institucioneve apeluese .....	34
<b>2.4 DIALOGU PUBLIK-PRIVAT .....</b>	<b>35</b>
A. Mungesa e studimeve të mëparshme të vlerësimit dhe të fizibilitetit mbi nevojën për të krijuar platforma dialogu publik-privat .....	36
B. Mbivendosja e platformave ekzistuese .....	37
C. Mungesa e rezultateve efektive .....	38
D. Mungesa e kanaleve të komunikimit në nivel lokal.....	39
E. Mungesa e transparencës në platformat ekzistuese .....	40
F. Mungesa e kapaciteteve teknike të sekretariateve përfaqësuese të platformave ekzistuese.....	40
G. Mungesa e implementimit efektiv të ligjit .....	41
<b>3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>43</b>
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>53</b>

## LISTA E SHKURTIMEVE

AAB	Shoqata Shqiptare e Bankave
ACA	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë
ACER	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
ACITAD	Dhoma Shqiptare e Tregtisë Ndërkombëtare dhe Zhvillimit
ACPST	Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit
AMCHAM	Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri
APKA	Shoqata e Konvertuesve të Plastikës së Shqipërisë
ARA	Shoqata Shqiptare e Riciklimit
ATA	Shoqata Shqiptare e Turizmit
CCI	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
CFA	Dhoma Shqiptare e Fasonit
CIPE	Qendra Ndërkombëtare për Sipërmarrje Private
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoria Rajonale e Tatimeve
KI	Këshilli Investimeve
NBA	Axhenda Kombëtare Biznesit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
NBF	Forumi Kombëtar i Biznesit
NCCS	Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile
KEK	Këshilli Ekonomik Kombëtar
SHGPAZ	Shoqata e Grave Profesioniste Afariste e Zejtare të Shqipërisë
RBF	Forumet Rajonale të Biznesit
SME	Sipërmarrjet të Vogla dhe të Mesme
KT	Këshilli Tatimor
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

NBA është rezultat i një punë të përbashkët dhe bashkëpunimi të vazhdueshëm i anëtareve të NBF, një rrjet i hapur i Dhomave të Tregtisë, Shoqatave të Biznesit dhe Organizatave të Tjera në Mbështetje të Biznesit në Shqipëri. Forumi mbështetet nga CIPE, si pjesë e programit: *“Shqipëria: Ndërtimi i një dialogu efektiv publik-privat”*.

Në vitin 2016 NBF vendosi të ndërtonte Axhendën Kombëtarë të Biznesit (NBA) për Shqipërinë, realizimi i së cilës kaloi në një seri konsultimesh me komunitetin e biznesit. Gjatë periudhës Qershor-Shtator, 2016 NBF zbriti në pesë rajonet më kryesore të Shqipërisë – Korçë, Fier, Durrës, Tiranë, Shkodër – duke zhvilluar pesë Forume Rajonale të Biznesit. Më shumë se 120 organizata biznesi dhe biznese janë takuar dhe kanë ndarë eksperiencat e tyre si dhe propozimet të lidhura me barrierat e të bërit biznes në Shqipëri. Gjatë Forumeve Rajonale të Biznesit (RBF), u identifikuan rreth 30 barrierat në të bërit biznes dhe në Shtator 2016, NBF vendosi që të ndërtojë NBA mbi katër fusha prioritare: informaliteti, kontrolli tatimor, sektorializimi i TVSH dhe dialogu publik-privat. Një ekip ekspertësh punoi mbi këto katër fusha në bashkëpunim edhe me anëtarët e NBF, për të bërë një analizë të thelluar e mbështetur në të dhëna, duke dhënë rekomandime politike me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator dhe ligjor në Shqipëri.

Ky dokument paraqet me detaje ndërhyrjet politike të nevojshme dhe veprimet që duhet të ndërmerren qeveria si dhe komuniteti i biznesit për përmirësimin e klimës së biznesit, duke marrë në konsideratë këto çështje: kontrolli tatimor, sektorializimi i TVSH, infomaliteti dhe dialogu publik-privat. Rekomandimet e lidhura me këto katër fusha, listohen si më poshtë:

### I. KONTROLLI TATIMOR

- Kontrolli tatimor të jetë i bazuar vetëm në **analizën e vlerësimit të riskut** dhe kjo duhet të zbatohet në të gjitha qarqet e Shqipërisë dhe kontrollet specifike lidhur me **procedurat e mbylljes** duhet të bazohen tërësisht në analizën e riskut;
- **Ngritjen e një strukture efektive për analizën e riskut** në DPT, me specialiste me eksperience e të përgatitur teorikisht;
- Zbatimi i një **projekt-pilot** për përzgjedhjen e plotë të tatimpaguesve për kontroll mbi bazën e analizës së riskut në DRT, gjatë **6-mujorit të dytë të 2017**;
- Administrata tatimore të **shprehet publikisht për afatin** kur do të bëjë të mundur implementimin e plotë të sistemit të analizës së riskut, në të gjithë drejtoritë rajonale të tatimeve;
- **Shtrirjen e rrjetit të shërbimit të tatimpaguesve** në disa qendra (jo vetëm në një për çdo qytet), për të qenë shumë më pranë përdoruesve të sistemit;
- **Ngritjen e një sistemi informimi të vazhdueshëm**, në të gjithë sportelet e QKB-së, aty ku bëhet regjistrimi fillestar i çdo biznesi;
- **Organizimi i tryezave publike informuese** me grup-biznese për të përditësuar periodikisht mbi ndryshime të akteve ligjore e nënligjore apo ndryshime të procedurave tatimore;

- DPT, të publikojë vendimet teknike dhe ligjet e reja ose të përmirësuara në faqen e saj, që komuniteti i biznesit të marrë informacion;
- Hartimi sa më shpejt të jetë e mundur i **akteve nënligjore** nga Ministria e Financave dhe gjithashtu rregullave përkatëse teknike, lidhur me zbatimin e procedurave të reja të kontrollit tatimor;
- Hartimi i një **manuali të ri të kontrollit tatimor** dhe publikimit në faqen zyrtare të administratës tatimore;
- DPT duhet të ushtrojë saktë detyrimin e tyre për të **informuar, edukuar dhe për të ndihmuar** bizneset, në mënyrë që ata mund t'u përmbahen detyrimeve të tyre të ligjore;
- Departamenti i Kontrollit Tatimor në DPT duhet t'u japë bizneseve mundësinë për të **diskutuar** dhe për të mbrojtur veten e tyre në **përputhje me ligjin**, gjatë kontrollit dhe në fund të tij;
- Departamenti i Kontrollit Tatimor dhe Departamenti i Apelit duhet të **kujdeset** për çdo akt konstatimi, çdo raport kontrolli në mënyrë që të jenë **në përputhje me ligjin** dhe të citojë në mënyrë të drejtë bazën ligjore të cilës i referohet, përndryshe ajo duhet të konsiderohet si një akt i pavlefshëm administrativ nga administrata tatimore;
- Administrata tatimore duhet të rrisë përpjekjet për të **lehtësuar përdorimin e sistemit elektronik** të tatimeve;
- **Rekrutimi i punonjësve të administratës tatimore** në veçanti, të kryhet sipas disa **rregullave strikte** të lidhura me përzgjedhjen e tyre;
- **Trajnimi për kandidatët** e përzgjedhur të jetë gjithashtu si kusht, përpara se ata të fillojnë punën në administratë;
- **Procesi i vlerësimit të performancës së inspektorëve/punonjësve** në administratën tatimore duhet të kryhet **rregullisht**, bazuar në direktivat e ligjit për Administratën Publike;
- Kontrolli praktik në vijimësi, gjatë gjithë vitit, nga strukturat e specializuara si të kontrollit tatimor, audituese dhe ato anti-korrupsion, duhet të jetë efektiv dhe **raportues për publikun** çdo vit kalendarik;
- Zbatimi i plotë i efektiv i **linjës telefonike** në Drejtorinë Tatimore, në lidhje me denoncimet e tatimpaguesve që kanë të bëjnë me raste abuzimi, sjelljeve të këqija etj.;
- DPT të publikojë **raportet vjetore** lidhur me indikatorët kundër **korrupsionit**.

## II. SEKTORIALIZIMI I TVSH-SË

- NBF rekomandon që ofrimi i shërbimeve nga **nënkontraktorët për kontraktorët të përpunimit aktiv, të taksohen me një normë tatimore të TVSH prej 0%**;
- NBF rekomandon Ministrinë e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë të marrin në konsideratë implementimin e **TVSH-së së reduktuar për sektorin bujqësor nga 20% në 10%**. Veç kësaj, NBF rekomandon Ministrinë e Financave që të rishikojë ligjin e TVSH-së në mënyrë që të jetë në përputhje me atë të Udhëzimeve të KE 2006/112, që do të thotë implementimin e Artikullin 98 të këtij udhëzimi në Shqipëri. Direktiva Evropiane 2006/112 / CE, datë 2016/11/28, kapitulli XII, ka përcaktuar:

"Shtetet anëtare kanë të drejtë të zbatojnë një regjim tatimor të paracaktuar (fiks) për prodhuesit bujqësorë në mënyrë që të kompensojnë shpenzimet për TVSH-në, për mallrat e blera dhe shërbimet e ofruara nga fermerët. Në direktivën e TVSH-së, është parashikuar regjimi i taksave të parapërcaktuara (fiks), shumë vende kanë ndjekur këtë linjë”;

- NBF rekomandon Ministrinë e Ekonomisë, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Turizmit, **të reduktoj TVSH e turizmit nga 20% në 10%**. Ky propozim është në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve të Këshillit 2006/112 të 28 Nëntorit 2006, “Në sistemin e përbashkët të TVSH” dhe me atë të Udhëzimeve të KE 2009/47.

### III. INFORMALITETI

- Ministria e Financave duhet të publikojë dhe të konsultojë **strategjinë paraprake** në lidhje me **reduktimin e informalitetit** në Shqipëri de të publikojë një axhendë zyrtare mbi këtë çështje;
- DPT duhet që të realizojë kontrollet tatimore tek të gjitha bizneset **pa dallim nga madhësia e tyre** duke u bazuar në analizën e vlerësimit të riskut dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financës duhet që të ndërmarrë fushata sensibilizuese për ti ndihmuar ato në procesin e gjatë të formalizimit;
- **Problematika e turizmit** lidhur me informalitetin, duhet të kalojë nën manaxhimin e pushtetit lokal;
- Administrata tatimore duhet të vendosë tek bizneset me qarkullim nga **2 deri në 8 milion Lek vetëm një taksë të thjeshtëzuar fitimi prej 5%**;
- Pragu i TVSH-së duhet të reduktohet nga **5 milion Lek duhet të jetë 2 milion Lek**;
- Rishikimin e normës së tatim fitimit dhe kthimin në nivelin e mëparshëm prej **10%**, i krahasueshëm me vendet fqinje;
- Qeveria duhet të **rrisë transparencën dhe llogaridhënien** e saj në lidhje me përdorimin e fondeve publike me një monitorim periodik të fondeve në nivel lokal dhe qendror;
- Bizneseve duhet tu lihet më shumë **kohë** në dispozicion përpara **hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore**.

### IV. DIALOGU PUBLIK-PRIVAT

- Përgatitja nga ana e platformave të dialogut, të një **liste të saktë të organizatave dhe shoqatave të biznesit apo dhomave të tregtisë e industrisë**, në mënyrë që të ketë një pamje të qartë të përfaqësimit të bizneseve të ndryshme në këto shoqata (sipas sektorëve, madhësisë etj.) dhe të përfaqësimit të tyre në tryezat e konsultimit;
- Ndërtimi i një **axhendë të qartë** me çështje konkrete që kërkojnë diskutim e zgjidhje, e përpiluar bazuar në komentet dhe rekomandimet e komunitetit të biznesit;
- **Organizimi i forumeve e tryezave më të vogla konsultative** bazuar në çështje specifike të identifikuar sipas axhendës në bashkëpunim me komunitetin e biznesit;
- Rritja e përpjekjeve të platformave për një **informim më të mirë** të komunitetit të biznesit mbi aktivitetet dhe qëllimet e tyre;
- Rritja e **kapaciteteve të sekretariateve teknike** (kur stafi është i pamjaftueshëm), në mënyrë që të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të kryer hulumtime, analiza, raporte,



përmbledhje të rekomandimeve, vëzhgime, etj, të biznesit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre;

- **Bashkëpunim të ngushtë** të sekretariateve teknike me përfaqësues të biznesit në mënyrë që të hartojnë axhendat vjetore dhe të zgjedhin temat e takimeve, etj.;
- **Bashkëpunim më i mirë** mes institucioneve shtetërore (nëpërmjet sekretariateve teknike) dhe organizatave e biznesit në lidhje me përgatitjen e sondazheve dhe studimeve apo projekteve të ndryshme;
- Platformat dhe ministritë përkatëse duhet të **publikojnë dokumentet** që shoqërojnë aktet normative gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe adaptimit (Tabela e divergjencave, rekomandimet dhe opinionet në çdo fazë të procesit të vendim-marrjes dhe termat e botimit);
- Duhet që të **publikohen** të gjitha rekomandimet e **marra nga komuniteti i biznesit** dhe pozicionin e institucioneve publike, pranimin apo refuzimin e tyre shoqëruar me argumentat përkatëse;
- Duhet të ketë më shumë mundësi për **përfshirjen e SME-ve** në informimin dhe vendimmarrjen në çështjet ekonomike;
- KEK të ngrëjë një **zyrë ankesash** në mënyrë që ti delegojë asaj përgjegjësinë e sekretariatit teknik ndaj ankesave; kështu secili mund të kryejnë në mënyrë efikase detyrat e saj përkatëse në lidhje me komunitetin e biznesit.

## HYRJJE

Gjatë dy viteve të fundit, qeveria shqiptare duke qenë në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të aderimit në Bashkimin Evropian, ka adaptuar politika me qëllim vendosjen e një tregu ekonomik të mirë-strukturuar që të jetë i aftë të përballojë presionet konkurruese kur Shqipëria ti bashkohet BE-së. Hapa pozitive janë ndërmarre në lidhje me përmirësimin e klimës së biznesit, megjithatë përpjekje të mëtejshme janë të domosdoshme për t'u ndërmarrë dhe miratuar në mënyrë që të prodhohen rezultate pozitive. Komuniteti shqiptar i biznesit vazhdon të përballlet me një mjedis rregullator mjaft të rënduar. Lidhur me këtë çështje janë bërë përpjekje për të lehtësuar “të bërit biznes” dhe për të përmirësuar dialogun me sektorin privat, por duhet ende punë që të arrihen rezultate të prekshme. Një tjetër problematikë e rëndësishme është ekonomia informale e cila parashikohet të jetë më shumë se një e treta e GDP-së së vendit<sup>1</sup> e cila shkakton humbje të mëdha tatimore, mungesë të mbrojtjes së fuqisë punëtore dhe konkurrencë të pandershme ndërmjet firmave. Prandaj, kërkohet një qasje me proaktive dhe efektive nga ana e qeverisë si dhe më shumë angazhim dhe bashkëpunim me komunitetin e biznesit.

Pavarësisht klimës së përgjithshme të paqëndrueshme në Shqipëri, komuniteti i biznesit realizoi disa arritje duke tejkaluar disa barriera në të “bërit biznes”. Ndërmjet aktorëve kyç të cilët janë angazhuar efektivisht në këtë përpjekje është NBF. Gjatë katër viteve të kaluara, NBF është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në advokimin e çështjeve të biznesit me zyrtarët publik për t'i ardhur në ndihmë krijimit të një klime të mirë biznesi gjë që është e domosdoshme për të nxitur rritjen ekonomike në vend.

Misioni i Forumit Kombëtar të Biznesit është të përfaqësojë interesat e bizneseve që operojnë në Shqipëri në dialogun me institucionet shtetërore. Qëllimet e këtij forumi janë si më poshtë:

- Gjetja e një gjuhe të përbashkët midis anëtarëve dhe pjesëmarrësve;
- Rritja e prezencës dhe e vizibilitetit në mjedisin e gjerë të biznesit në vend;
- Fuqizimi i rolit të komunitetit të biznesit në dialog me zyrtarët publik;
- Inicimi i politikave të reja për përmirësimin e mjedisit të biznesit.

Forumit Kombëtar të Biznesit aktualisht përbëhet nga 9 anëtarë themelues<sup>2</sup> dhe dy partnerë<sup>3</sup>. Anëtarët themelues të Forumit Kombëtar të Biznesit janë: ACER, ACA, ACITAD, CCI, SHGPAZ, ARA, APKA, CFA, ATA. Dhoma Amerikane e Tregtisë (AMCHAM) dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) janë partnerët e NBF.

Në vitin 2014, NBF vendosi të trajtojë me prioritet çështjen e kontrollit tatimor. Për këtë arsye u zhvillua një studim dhe anëtarët e NBF zhvilluan një set rekomandimesh dhe u angazhuan në advokimin me qeverinë për të adresuar çështjet lidhur me kontrollin tatimor.<sup>4</sup> Në fillim të vitit 2015, anëtarët e NBF, pas një sërë konsultimesh me komunitetin e biznesit

<sup>1</sup> Komisioni Evropian, Progres Raporti, 2016, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)

<sup>2</sup> Anëtarë themelues janë ata që kanë nënshkruar Memorandumin e Anëtarësisë në 22 Nëntor 2013.

<sup>3</sup> Partnerë janë ata që nuk kanë nënshkruar ende Memorandumin e Anëtarësisë por mbështesin Forumin.

<sup>4</sup> [http://www.nbf.al/images/problematika\\_te\\_kontrollit\\_tatimor\\_tek\\_bizneset\\_private\\_ne\\_shqiperi.pdf](http://www.nbf.al/images/problematika_te_kontrollit_tatimor_tek_bizneset_private_ne_shqiperi.pdf)

ranë dakord që të trajtonin çështjen e formalizimit të biznesit e cila më pas u bë gjithashtu një prioritet i qeverisë Shqiptare, si rezultat i përpjekjeve të NBF-së. Për këtë të fundit, NBF zhvilloi një studim në 400 biznese të cilat operojnë në të gjithë vendin dhe duke u bazuar në të dhëna primare prodhoi një dokument politikash.<sup>5</sup>Në fillim të vitit të kaluar vendosi të zgjerojë kontekstin e analizës kundrejt sfidave të komunitetit të biznesit dhe vendosi që të ndërtojë NBA për Shqipërinë. Kjo axhendë është një mjet që mundëson identifikimin e barrierave të biznesit dhe pas kësaj ofron rekomandime politike që mundësojnë tejkalimin e këtyre barrierave. NBA krijon mundësinë që baza të shprehë shqetësimet e hasura dhe gjithashtu të propozojë zgjidhjet përkatëse.

Qëllimet kryesore të NBA janë:

- Të tërheqë një pjesëmarrje më të madhe të komunitetin të biznesit nga të gjithë sektorët ekonomik;
- Të sigurojë propozime për tejkalimin e pengesave të biznesit dhe më pas këto të fundit të prodhojnë ndryshime pozitive në mjedisin e biznesit;
- Të përmirësojë kuadrin ligjor dhe rregullator të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë të sektorit privat;
- Të sigurojë argumenta të fortë për ndryshimet e politikave dhe të shpjegojë sesi këto ndryshime do të sjellin efekte pozitive në klimën e përgjithshme të biznesit

Në mënyrë që të arrihen këto objektiva, NBA-ja paraqet disa rekomandime politike të lidhura me katër prioritete të përshkruara nga aktorët e gjerë të biznesit në të gjithë vendin:

- Kontrolli tatimor;
- Sektorializimi i TVSH-së;
- Informaliteti;
- Dialogu publik-privat.

NBA është e organizuar si më poshtë: Kapitulli i parë përshkruan metodologjinë e përdorur tek NBA-ja. Ky seksion siguron informacion në lidhje me hapat që NBF ka ndjekur në mbledhjen e inputeve bazë për sfidat e biznesit në Shqipëri, më pas vijon Kapitulli 2 që trajton procesin e përzgjedhjes së fushave më të rëndësishme të studimit. Kapitulli 3 përfshin përshkrimin e katër çështjeve madhore së bashku me nën çështjet respektive të lidhura gjithashtu me të dhëna dhe rekomandime. Secila nga çështjet është ndarë në nën çështje përkatëse. Kapitulli 4 thekson gjetjet kryesore dhe rekomandimet e propozuara nga NBF dhe në fund të dokumentit jepet lista e burimeve sekondare të konsultuara gjatë ndërtimit të NBA.

---

<sup>5</sup>[http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)

## **1. METODOLOGJIA**

Zhvillimi i NBA kaloi përmes tre fazave të mëposhtme:

### **1. Identifikimi i sfidave aktuale të biznesit**

NBF ka bërë përpjekje të mëdha për të identifikuar shqetësimet direkte me të cilat përballej komuniteti i biznesit në rajonet më të rëndësishme të vendit. Në procesin e identifikimit të problematikave të biznesit morën pjesë 113 organizata në të gjithë Shqipërinë. Në Gusht-Shator 2016, FRB u realizuan në rajonin e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Durrësit dhe Fierit.<sup>6</sup>

Këto RBF përbëheshin nga lider të bizneseve rajonale të cilët bashkëvepronin drejtpërdrejt me komunitetin lokal të biznesit, shumica e të cilëve ndiheshin si të parëndësishëm në vendimmarrje dhe në procesin e politik-bërjes. RBF rezultoi me diskutime mjaft konstruktive e të frytshme dhe kontribuoi në kuptimin e problemeve të shumta që komuniteti i biznesit përballej. Për më tepër, anëtarët gjatë RBF kishin mundësi që të vendosnin prioritetet për problemet e secilit rajon duke u koordinuar nga Njësia Koordinuese e NBF.

### **2. Zgjedhja e sfidave kombëtare të biznesit**

Mbas realizimit me sukses të FRB, anëtarët e NBF u mblodhën dhe diskutuan gjetjet dhe propozimet e ngritura nga komuniteti rajonal i biznesit. Pas një diskutimi të brendshëm ndërmjet anëtarëve, u ra dakord të trajtoheshin në NBA katër çështje: çështja e dialogut publik-privat, informaliteti, kontrolli tatimor dhe TVSH-ja në sektorë të ndryshëm. Pjesëtarët e NBF zgjedhën çështje të cilat kishin ndikim në një segment të gjerë biznesesh. Për më tepër, zgjedhja e këtyre çështjeve ishte e bazuar në konsiderimin si prioritetet më të mëdha, në mënyrë që këto rekomandime të merren në konsideratë nga qeveria Shqiptare dhe më pas të angazhohet ndjekja e tyre.

### **3. Zhvillimi i NBA**

Pas zgjedhjes së çështjeve të përmendura më lart, NBF kontrakttoi ekspertët më të shquar të cilët dispononin eksperiencë të madhe për çështjet e zgjedhura. Këta të fundit u përdorën për të përkthyer inputet e mbledhura nga RBF në një dokument profesional të mbështetura me të dhëna të mjaftueshme.

NBA paraprake u konsultua intensivisht me liderët e bizneseve rajonale, përfaqësuesit e RBF (përfaqësuesit e biznesit, agjencitë e biznesit, bizneset që ishin pjesëmarrës gjatë RBF-ve), anëtarët e NBF, etj., në mënyrë që të merrej feedback-u i tyre dhe të forcoheshin rekomandimet politike drejt institucioneve publike. Pas kësaj, ekspertët përfshinë pjesën më të madhe të sugjerimeve/komenteve të mbledhura dhe përgatitën versionin përfundimtar të NBA.

---

<sup>6</sup> Përqindja e bizneseve që operojnë në këto rajone: Tiranë 36%, Korçë 8%, Shkodër 7%, Durrës 9%, Fieri 13%.

## **2. PRIORITETET E FORUMIT KOMBËTAR TË BIZNESIT PËR VITIN 2017**

### **2.1. KONTROLLI TATIMOR**

#### **Hyrje**

Sistemi tatimor në Shqipëri bazohet mbi disa parime të sanksionuara të cilat zënë një pjesë të konsiderueshme në administratën tatimore. Qëllimi i parimeve mbi të cilat funksionon sistemi tatimor shqiptar është:

- Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor të çdo biznesi, nëpërmjet informimit, edukimit si dhe nëpërmjet përdorimit të proceseve të modernizuara;
- Vendosja e një ekuilibri më të mirë ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve të tatimpaguesve;
- Mbështetje e procesit të integritetit evropian, përmes praktikave ndërkombëtare tatimore në administrimin tatimor në vend.

Kontrolli tatimor, referuar situatës konkrete të ndërveprimit mes bizneseve dhe inspektorëve tatimorë, është një nga aspektet më problematike në të bërit biznes. Kjo për shkak të marrëdhënieve mosbesuese mes dy palëve, ku inspektorët tatimorë paragjykojnë saktësinë e deklarimeve të depozituara nga bizneset dhe në një farë mënyre kanë tendencë vendosjen e gjobave dhe bizneset qasen ndaj tyre duke i ofruar ryshfet për të siguruar një rezultat kontrolli, në mos të favorshëm, të arsyeshëm.<sup>7</sup> Gjobat e parashikuara nga ndryshimet e bëra në ligjin tatimor të vitit 2015, ishin të papërbalueshme përveçse të paarsyeshme. Aq më shumë rëndohet kjo situatë nga fakti që bizneseve i kërkohet të parapaguajnë masën e pretenduar të detyrimeve (detyrimi tatimor dhe kamatëvonesat), që të mund të shqyrtohen nga apelimi tatimor e më pas për t'u ankimuar në gjykatë. Në vijim, një sistem gjyqësor me probleme dhe i korruptuar nuk ofron garanci as për ushtrimin e të drejtës së ankimit gjyqësor.

Gjithashtu, ekzistojnë shumë raste ku legjislacioni tatimor lë hapësirë për interpretim, duke i dhënë në këtë mënyrë një interpretim personal të inspektorit tatimor. Mungesa e direktivave të qarta reflektohet njëkohësisht edhe në faqen e tatimeve ku rrallë here publikohen direktivat apo vendimet teknike, edhe pse një gjë e tillë parashikohet në ligj. Për më tepër, situata përkeqësohet edhe për shkak të ndryshimeve të shpeshta ligjore që i japin shumë pak kohë në dispozicion komunitetit të biznesit që të informohen. Këto situata krijojnë pasiguri duke dëmtuar në këtë mënyrë aktivitetin e biznesit dhe ekonominë në tërësi.

#### **A. Mosfunksionimi i plotë i sistemit të përzgjedhjes në bazë të riskut**

##### ***Perqasja ligjore***

Një bazë ligjore e plotë ekziston për sa i takon detyrimin të administratës tatimore për të përdorur metodën e përzgjedhjes për kontroll bazuar në analizën e riskut. Kjo bazë ligjore pasqyrohet kryesisht në ligjin bazë procedural, por dhe në aktin tjetër nënligjor, udhëzimin e nxjerrë nga Ministria e Financave, në zbatim të këtij ligji. Në aspektin organizativ të administratës tatimore, është neni 16 i Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i

<sup>7</sup> Forumi Kombëtar i Biznesit. (2016) Këndvështrimi i Forumit Kombëtar të Biznesit mbi çështjen e informalitetit në Shqipëri.

[http://www.nbf.al/images/K%C3%ABndv%C3%ABshtrimi\\_i\\_Forumit\\_Komb%C3%ABtar\\_t%C3%AB\\_Biznesit\\_mbi\\_%C3%A7%C3%ABshjtjen\\_e\\_informalitetit\\_n%C3%AB\\_Shqip%C3%ABri.pdf](http://www.nbf.al/images/K%C3%ABndv%C3%ABshtrimi_i_Forumit_Komb%C3%ABtar_t%C3%AB_Biznesit_mbi_%C3%A7%C3%ABshjtjen_e_informalitetit_n%C3%AB_Shqip%C3%ABri.pdf)

cili ka përcaktuar në pikën 3 të nenit 16 të tij, menaxhimin e riskut si një funksion të veçantë operacional. Nga ana tjetër, ligji procedural, parashikon përdorimin e analizës së vlerësimit të riskut për të zgjedhur ata tatimpagues që do t'i nënshtrohen kontrollit tatimor.<sup>8</sup> Po ashtu, në të njëjtin ligj është theksuar e përcaktuar, specifikisht për efekt të procedurës së rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), kontrolli mund të kryhet bazuar në një seleksionim, në analizën e vlerësimit sipas riskut, të atyre bizneseve tatimpagues që kërkojnë një rimbursim të tatimit.<sup>9</sup>

Ligji i procedurave gjithashtu, ka vendosur përdorimin e metodës së analizës së vlerësimit të riskut, në rastin e procedurës që ka të bëjë me kontrollin e bizneseve, në rastin e mbylljes përfundimtare të aktivitetit të tyre.<sup>10</sup> Në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 24, datë 24.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 80.3, gërma a), në mënyrë specifike, kërkohej që për kontrollet e thelluara në vend, përzgjedhja të bëhet në bazë të analizës së riskut.

### **Aspekti metodologjik**

Vlerësimi i riskut në lidhje me kontrollin e tatimpaguesve, është përdorur nga të gjitha vendet e BE-së, si dhe nga shumë vende rajonale. Raporti i fundit i progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë mbështet dhe inkurajon DPT-n të zbatojë vlerësimin e riskut. Në mënyrë të veçantë, në këtë raport thuhet: "Përdorimi i kontrollit dhe inspektimeve, në bazë të vlerësimit të riskut, në shërbimet tatimore dhe doganore janë rritur, por duhet të rritet më tej. Përpjekjet janë në vazhdim për të trajtuar korrupsionin në administratën tatimore dhe doganore, e cila përsëri mbetet një shqetësim".<sup>11</sup>

Analiza e vlerësimit të riskut është një analizë e kosto/përfitimit, që ka si rezultat zgjedhjen e deklaratave që gjenerojnë të ardhura tatimore më të mëdha shtesë, brenda kohës më të shkurtër dhe me koston më të ulët. Nga pikëpamja e administrimit tatimor në vend, vlerësimi i riskut është i vlefshëm dhe i përdorshëm për të identifikuar ato biznese apo grup biznesesh, të cilët kanë më shumë rrezik për ta shkelur ligjin. Nga pikëpamja statistikore, metoda bazohet në një proces të vazhdueshëm të mbledhjes dhe analizimit të treguesve financiarë e fiskalë, variacionit të tyre në kohë apo në krahasim me situata të ngjashme midis bizneseve.

Metodikisht vlerësimi i riskut bazohet në :

- Analizën statistikore e të dhënave pjesë përbërëse të deklaratës/deklaratave tatimore, të një periudhe të caktuar tatimore.

<sup>8</sup> Paragrafi 4 i Nenit 80 të Ligjit Nr. 9920 datë 19 Maj 2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

<sup>9</sup> Neni 75/1 i ligjit, i cili në paragrafin e dytë të pjesës së parë, përcakton “brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tatimpaguesit eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, ku tatimpaguesi është i regjistruar, verifikon gjendjen tatimore të tatimpaguesit dhe miraton bilancin e depozitave si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore kryen inspektim bazuar në analizën e rrezikut”

<sup>10</sup> Paragrafi 4 i Nenit 45 të Ligjit të lart përmendur, ka përcaktuar që “Organi kompetent tatimor brenda 10 ditëve nga data e kërkesës për çregjistrim, sipas paragrafit 3, të këtij neni, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njëkohësisht njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit, ose të njoftojë gjykatën dhe subjektin. Kur organi tatimor, në bazë të analizës së rrezikut, e konsideron si të nevojshme për të ushtruar inspektimin brenda mjedisit të aktivitetit të njësisë ekonomike, atëherë ky afat nuk mund të jetë më i madh se 30 ditë pune, duke përfshirë kryerjen e inspektimit ”.

<sup>11</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf).

- Në rezultatet e kontroleve të mëparshme tatimore tek një biznes apo grup biznesesh.
- Nga informacioni i mbledhur nga palë të treta si:
  1. marrëdhëniet kontraktore midis bizneseve (shitje mallrash e kryerje shërbimesh midis tyre);
  2. banka të nivelit të dytë;
  3. transaksione ndërkombëtare të import-eksportit si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve;
  4. zyra të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
  5. zyra noteriale, avokatore, të ekspertizës kontabël;
  6. prokurimet publike, etj.

Nga pikëpamja ekonomiko-financiare kjo metodë ul ndjeshëm kostot administrative të administratës tatimore, pasi përqendrimi bëhet në biznesin apo grup bizneset me tregues fiskalë jo vetëm të përkeqësuar, por edhe më potencialë për mbledhjen e të ardhurave, duke rritur ndjeshëm rendimentin e mbledhjes së tyre. Njëkohësisht, kjo metodë është ekonomike edhe për vetë bizneset, pasi grupi më i rregullt fiskalisht, nuk angazhohet në një aksion me kosto të paraqitur nga një proces kontrolli i thelluar tatimor.

**Sistemi i përzgjedhjes bazuar në vlerësimin e analizës së riskut, mbetet akoma në një fazë zhvillimi, duke mos dhënë rezultatet e pritshme**

Ndonëse kanë kaluar mbi 6 vjet që nga hyrja në fuqi e detyrimit të përzgjedhjes për kontrollin tatimor të bizneseve, në vitin 2008 (kërkesë e procedurave të reja tatimore) mbi bazën e analizës së riskut, në praktikë rezultati nuk është i të njëjtës kahje. Ky sistem ka filluar zbatimin e tij vetëm në Tiranë dhe jo në rajonet e tjera. Për më tepër, në Tiranë disa raste nuk janë zgjedhur me këtë sistem. Ankesat e biznesit dhe gjetje të tjera që vijnë nga debatet me përfaqësuesit e administratës tatimore tregojnë një përqindje të ulët të zbatimit të sistemit të përzgjedhjes bazuar në analizën e riskut.

Sistemi përzgjedhjes në bazë të vlerësimit të analizës së riskut është paraqitur në mesin e vitit 2008, por deri më tani zbatimi mbetet i pamjaftueshëm. Në mënyrë të veçantë, në bazë të të dhënave të DPT, vetëm 60% e bizneseve, subjekt i kontrollit tatimor janë përzgjedhur duke u bazuar në vlerësimin e riskut, ndërsa pjesa e mbetur janë përzgjedhur nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse në mënyrë manuale. Sistemi nuk ishte implementuar gjatë aksioneve kundër informalitetit kur 180.000 biznese u kontrolluan pa u marrë në konsideratë vlerësimi i analizës së riskut. Për këtë fakt nuk ka të dhëna të publikuara nga DPT.

Për këtë qëllim, NBF rekomandon DPT që kontrolli tatimor të jetë i bazuar vetëm në analizën e vlerësimit të riskut dhe kjo duhet të zbatohet në të gjitha qarqet e Shqipërisë.

**Sistemi i vlerësimit bazuar në analizën e riskut, akoma nuk po e gjen aplikimin në përputhje me detyrimin ligjor**

Pothuaj të gjithë bizneset që aplikojnë në sportelet e QKB-së, për mbyllje përfundimtare, i nënshtrohen kalvarit të pambarimtë të pritjes së detyruar për t'u kontrolluara, përpara lejimit të veprimit të çregjistrimit nga regjistrat tregtarë. Bazuar në ligjin e procedurave tatimore, kontrollet që administrata tatimore duhet të kryejë në këto raste, specifike, duhet t'i

nënshtrohen parimit të përgjithshëm, atij të përzgjedhjes në bazë të analizës së riskut. Sipas pjesëmarrësve në takimet e RBF këto procedura zgjasin deri në tre vjet dhe kjo periudhë është e shoqëruar njëkohësisht me akumulim e dënimeve (gjobave). Përveç kësaj, shpenzime të tjera të fshehta shoqërojnë të gjithë këtë proces, sidomos për shoqëritë tregtare që fillimisht janë në fazën e likudimit.

NBF **rekomandon DPT** që kontrollet specifike lidhur me procedurat e mbylljes të bazohen tërësisht në analizën e riskut.

**Sistemi i vlerësimit bazuar në analizën e riskut, akoma nuk po i shërben përpjekjeve dypalëshe administratë – biznes, për minimizimin e informalitetit në vend**

Aktualisht, në Shqipëri ekziston një regjim i fraksionuar i tatimit mbi të ardhurat. Përqendruar vetëm në tatimin mbi fitimin, vendosja e përjashtimit prej tij e grup bizneseve që janë regjistruar nën një qarkullim 5 milionë lekë, më pas ato deri në 8 milionë lekë, krijojnë një “çarje” në sistem. Grupet e bizneseve që janë nën pragun 8 milionë e sidomos 5 milionë lekë, janë të pa interesuar të formalizojnë dokumentacionin e tyre. Shpesh herë bizneset e regjistruara në një regjim normal taksimi të tatimit mbi fitimin (mbi 8 milionë lekë), ngrenë shqetësimin e mospranimit të faturave të lëshuara prej tyre, nga bizneset e regjistruara në pragjet e ulëta. Përvoja deri më sot tregon që ky proces formalizimi nuk mund të arrihet me kontrolle në shkallë të gjerë, apo ndryshe frontale. Një numër biznesesh u regjistruan rishtazi, por një numër i ndjeshëm u mbyllën, apo kaluan në një status pasiv.

Duke e konsideruar vlerësimin e bazuar në analizën e riskut, si elementin kyç avantazhues si për administratën tatimore edhe për biznesin në tërësi, **NBF rekomandon:**

- Ngritjen e një strukture efikase të analizës së riskut, organizative në qendër, pra në drejtorinë qendrore të tatimeve (DPT), me specialiste me eksperience e të përgatitur teorikisht;
- Zbatimin e një projekt-pilot për përzgjedhjen e plotë të tatimpaguesve për kontroll mbi bazën e analizës së riskut të paktën në tre drejtori rajonale tatimore, gjate 6-mujorit të dytë të 2017;
- Me qëllim shkurtimin e ndjeshëm të afatit të çregjistrimit përfundimtar të bizneseve, kontrollet specifike që lidhen me procedurën e mbylljes, të bazohen tërësisht në analizën e riskut.
- Administrata tatimore të shprehet publikisht për afatin kur do të bëjë të mundur implementimin e plotë të sistemit të analizës së riskut, në të gjithë drejtoritë rajonale të tatimeve.



## **B. Mos zbatim i të drejtës së informimit dhe të njoftimit të tatimpaguesve**

E drejta e informimit e çdo biznesi (tatimpaguesve) është një detyrim ligjor për administratën tatimore.<sup>12</sup> Në takimet e zhvilluara me anëtarët e NBF, ato konstatojnë dhe njëkohësisht deklarojnë, se përpjekjet e sforcuara të administratave rajonale, për t'i detyruar që të regjistrohen, nuk shoqërohen me informimin e tyre, për detyrimet që atyre u lindin gjatë një viti kalendarik, si për efekt të deklaratave ashtu edhe pagesave. Asnjë përfaqësues i administratës së tatim-taksave nuk ndodhej pranë sportelit të QKB, qoftë edhe për inspektim të procesit të informimit. Mosfunksionimi i një sistemi funksional informimi, pavarësisht se është detyruar ligjërisht për administratën, shpesh i ka ekspozuar bizneset, sikurse ato thonë, përpara dënimeve me gjoba, apo papërgatitje të plotë për t'u përballur me verifikimet e kontrollet e shpeshta. Rasti konkret, që anëtarët e NBF e ngritën në të gjithë takimet në qarqet, ishte ai që kishte të bënte me gjobitjen masive, pothuaj të të gjithë tatimpaguesve, kryesisht me statusin e personave të vetëpunësuar, por edhe persona juridikë, në periudhën maj-qershor 2016, për mosdorëzimin e një formulari që kishte të bënte me personat e punësuar rishtazi, në cilësinë e administratorit të biznesit, pavarësisht faktit që ato ishin të regjistruar, pra formalë. Në pothuaj të gjithë takimet e NBF, u ngrit problemi i mosnjoftimit paraprak para një kontrolli, sidomos dukshëm përsa i takon një vizite fiskale. Bizneseve nuk u lihet kohë e domosdoshme e mbledhjes së informacionit, apo prezantimit të tij nga ekspertët e kontraktuar, por shpesh gjobiten për mosmbajtje dokumentacioni e të dhënash. Ndërkohë që një kohë shumë e ngushtë përgatitore, ose e papërfillshme, u lihet bizneseve për t'u përgatitur përballë një kontrolli të thelluar në vend. Herë–herë, kontrollet kanë synuar “befasinë”, më parë se bashkëpunimin, debatin profesional, partneritetin real.

Bizneset e Tiranës, në takimin e RBF prezantuan si problem mohimin e të drejtës për t'u njoftuar, konkretisht mosdhënien nga administrata tatimore të njoftim-vlerësimit tatimor, dokument pa të cilin atyre u hiqet e drejta e apelimit të një detyrimi tatimor të nxjerrë nga administrata tatimore.

**NBF**, inkurajon çdo përpjekje që rrit cilësinë e shërbimit e edukimit të të gjithë bizneseve në vend, **rekomandon:**

- Shtrirjen e rrjetit të shërbimit të tatimpaguesve në disa qendra (jo vetëm në një për çdo qytet), për të qenë shumë më pranë përdoruesve të sistemit;
- Ngritjen e një sistemi informimi të vazhdueshëm, në të gjithë sportelet e QKB-së, aty ku bëhet regjistrimi fillestar i çdo biznesi;
- Organizimin e tryezave publike informuese me grup-biznese për të përditësuar periodikisht ndryshime të akteve ligjore e nënligjore, çdo përmirësim të procedurave tatimore;
- DPT, të publikojë vendimet teknike<sup>13</sup> dhe ligjet e reja ose të përmirësuara në faqen e saj, që komuniteti i biznesit të marrë informacion.

---

<sup>12</sup> Neni 30 i ligjit nr. 9920, 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

<sup>13</sup> Vendimi teknik i referohet rregullave të publikuara nga DPT, të cilat ofrojnë përgjigjet për interes të çdo taksapaguesi. Në rast se interesi i tatimpaguesit mund të ketë një ndikim më të madh në tatimpaguesit e tjerë, GTD mund të publikojë një rregullore të përgjithshme, të cilit ligji procedural i referohet si një vendim teknik.

## C. Moszbatueshmëri e së drejtës për kontrolle të arsyeshme

Lidhur me moszbatueshmërinë e përzgjedhjes së tatimpaguesve të cilët do të jenë subjekt i kontrollit tatimor dhe duke marrë parasysh deklaratat e anëtarëve të NBF, ka mungesë të zbatimit të së drejtës së tatimpaguesit për kontrolle të arsyeshme. Neni 33 i ligjit procedural, formuluar si vijon:

*“Tatimpaguesi ka të drejtë t’i sigurohen kontrolle të arsyeshme, të cilat të kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave të këtij ligji”.*

Ndryshimet më të fundit në procedurat tatimore, vendosur me ligjin nr. 112/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, janë një përfaqje pozitive të paktën për sa i takon aspektit procedural, si në drejtim të informimit të tatimpaguesve, programimit të fillimit të një kontrolli tatimor dhe programimit të zhvillimit të një kontrolli tatimor. Një aspekt i rëndësishëm pozitiv i përfshirë në amendamentet e fundit ligjore të aprovuara në 2016, është mundësia që iu është dhënë bizneseve për të vetëdeklaruar transaksionet e tyre të padeklaruar. Avantazhi i vetëdeklarimit ka të bëjë me reduktimin e dënimeve. Në rast shkeljeje, nëse ekziston mundësia për dy dënime të ndryshme, Inspektoriat i Punës aplikon dënimin më të ulët, pra në avantazh të tatimpaguesit.

Duke mbështetur ndryshimet dhe përmirësimet e mësipërme proceduriale, **NBF rekomandon:**

- Hartimi sa më shpejt të jetë e mundur i akteve nënligjore nga Ministria e Financave dhe gjithashtu rregullave përkatëse teknike, lidhur me zbatimin e procedurave të reja të kontrollit tatimor;
- Hartimi i një manuali të ri të kontrollit tatimor dhe publikimit në faqen zyrtare të administratës tatimore.

## D. Dënime administrative të pamotivuar

Në diskutimet e RBF, u evidentua problemi i vendosjes së dënimeve administrative, nga inspektimet tatimore, sidomos ato që merren me terrenin, në mënyrë të paargumentuar, pa u mbështetur në prova dhe bazuar në ligj. Rastet më tipike:

- Gjobitje si persona të paregjistruar tek tatimpaguesi, persona të afërm të tij, por që në momentin e kontrollit janë ndodhur rastësisht, në ambientin e biznesit;
- Gjoha për moslëshim të kuponit tatimor, ku ka patur konstatime të përgjithshme, që përshkruajnë vetëm, “nuk lëshon” kupon tatimor, kur në fakt biznesi nuk ka kryer asnjë shitje malli;
- Detyrime tatimore të shoqëruara me gjoha, në përfundim të kontrolleve tatimore në vend, pa u mbështetur në asnjë ligj fiskal dhe pa u dhënë argumentat mbështetëse.

Shumica e ndëshkimeve janë vendosur pas përfundimit të kontrollit, pa një diskutim paraprak me përfaqësues të biznesit dhe në mospërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

**NBF**, duke pasur parasysh problemet që kanë rezultuar me pasoja të konsiderueshme financiare dhe në mënyrë për të shmangur dënimet me pasoja të pakthyeshme për bizneset, **rekomandon:**

- Departamentet përgjegjëse në DPT për ofrimin e shërbimeve dhe edukimin e tatimpaguesve, të ushtrojnë saktë detyrimin e tyre për të informuar, edukuar dhe për të ndihmuar bizneset, në mënyrë që ata mund t’u përmbahen detyrimeve të tyre të ligjore;

- Departamenti i Kontrollit Tatimor në DPT duhet t'u japë bizneseve mundësinë për të diskutuar dhe për të mbrojtur veten e tyre në përputhje me ligjin, gjatë kontrollit dhe në fund të tij;
- Departamenti i Kontrollit Tatimor dhe Departamenti i Apelit duhet të kujdeset për çdo akt konstatimi, çdo raport kontrolli në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjin dhe të citojë në mënyrë të drejtë bazën ligjore të cilës i referohet, përndryshe ajo duhet të konsiderohet si një akt i pavlefshëm administrativ nga administrata tatimore.

## **E. Sistemi i prezantuar rishtazi ka krijuar disa probleme**

Një shqetësim me të cilin komuniteti i biznesit po përballet prej dy vjetësh, sipas anëtarëve pjesëmarrës në takimet e zhvilluara në RBF, ka të bëjë me implementimin e sistemit të ri elektronik të tatimeve. Kujtojmë që një gjobë e gjeneruar gabimisht, pasohet me marrjen e masave shtrënguese të mbledhjes me forcë nga administrata, ku më e lehta është ajo e bllokimit të të gjithë llogarive bankare të biznesit. Në udhëzimin e ministrit të Financave, nr. 24, datë 9.12.2014 *“Për dhënien e pëlqimit dhe mënyrën e marrjes dhe vlefshmërinë e dhënies së pëlqimit për komunikimin elektronik të tatimpaguesit me administratën tatimore”*, në paragrafin nr 13, me titull *“Detyrimet e administratës tatimore”*, jepet ky formulim, që e citojmë të plotë :

*13.1 Administrata tatimore nuk mban përgjegjësi për asnjë humbje, e cila ka ardhur si pasojë e rrethanave apo shkaqeve, që nuk janë në kontrollin direkt të tij, ku përfshihet, por pa u kufizuar vetëm në to, dështimi elektronik ose mekanik i pajisjeve si të “e-user”-it ashtu edhe të atyre të shërbimit “e-tax” për të pranuar transmetimin e veprimeve, probleme në linjën e internetit, probleme të tjera të pajisjeve të transmetimeve elektronike ose fatkeqësi natyrore.*

*13.2 Administrata tatimore nuk garanton saktësinë, mjaftueshmërinë ose përsosmërinë e informacionit dhe dokumenteve të siguruara nga shërbimi “e-tax”, dhe në mënyrë të veçantë ajo është e përjashtuar nga përgjegjësia për gabime ose ndryshime në këto dokumente.*

*13.3 Administrata tatimore nuk garanton se e drejta e aksesit për në sistemin e shërbimit “e-tax”, ose informacioni apo funksionet do të sigurohen të pandërprera dhe pa gabime, ose pa ndërhyrjen e një pale të tretë të paautorizuar në to.*

*13.4 Administrata tatimore, nuk do të jetë përgjegjëse në asnjë rast, që ka të bëjë me humbje ose dëmtime sido që të jetë shkak i ardhjes së tyre.*

### **NBF rekomandon:**

- Administrata tatimore duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë, diktuar nga roli i saj në marrëdhëniet e partneritetit me biznesin;
- Administrata tatimore duhet të plotësojë detyrimin e saj për të mundësuar informimin e përhershëm të tatimpaguesve;
- Administrata tatimore duhet të rrisë përpjekjet për të lehtësuar përdorimin e sistemit elektronik të tatimeve.

## **F. Niveli etik dhe profesional i inspektorëve tatimore.**

Përgjatë diskutimeve në RBF, vlen të përmendet si një çështje e rëndësishme, shqetësimi i kapaciteteve profesionale të inspektorëve tatimor. Nga një pjesë e administratës, përfshirë sidomos atë tatimore, reflekton fenomene negative si paaftësia profesionale, mungesa e etikës, mungesa e transparencës, të cilat krijojnë një klimë shumë favorizuese të shfaqjeve korruptive. Inspektorët tatimorë shpeshherë nuk bashkëpunojnë me tatimpaguesin gjatë procesit të një kontrolli tatimor. Në disa raste, ato kanë kundërshtuar të bashkëpunojnë me departamentin e financës së tatimpaguesit.

Gjatë RBF, pjesëmarrësit pranuan se inspektorët tatimore nuk kanë një sjellje të pranueshme, apo veshje zyrtare dhe në shumicën e rasteve ato shfaqen me mungesë të aftësive profesionale. Ata pranun se pjesa më e madhe e inspektorëve tatimore rekrutohen të ndikuar nga politika, pa patur standardet minimale profesionale.

Duke i konsideruar serioze problemet e kësaj natyre, **NBF rekomandon:**

- Rekrutimi i punonjësve të administratës tatimore në veçanti, të kryhet sipas disa rregullave strikte të lidhura me përzgjedhjen e tyre. Krahas ligjit përkatës të administratës publike, të vihen edhe kërkesa të forta të natyrës së formimit profesional, arsimor të përgjithshëm dhe atij etik. Përzgjedhja e tyre, të mund të kryhet nga një komision miks, duke përfshirë disa institucione financiare e universitare;
- Trajnimi për kandidatët e përzgjedhur të jetë gjithashtu si kusht, përpara se ata të fillojnë punën në administratë. Njëkohësisht trajnime periodike, të paktën 4 herë në vit, ku mund të ketë bashkëpunim dhe përfshirje edhe të specialistëve, ekspertëve, këshilltarëve të biznesit, të bëhen traditë;
- Procesi i vlerësimit të performancës së inspektorëve/punonjësve në administratën tatimore duhet të kryhet rregullisht, bazuar në direktivat e ligjit për Administratën Publike. Ajo mund të përdoret si një instrument i besueshëm dhe transparent për të vlerësuar karrierën e gjithkujt;
- Kontrolli praktik në vijimësi, gjatë gjithë vitit, nga strukturat e specializuara si të kontrollit tatimor, audituese dhe ato anti-korrupsion, duhet të jetë efektiv dhe raportues për publikun çdo vit kalendarik;
- Zbatimi i plotë i efektiv i linjës telefonike në Drejtoritë Tatimore, në lidhje me denoncimet e tatimpaguesve që kanë të bëjnë me raste abuzimi, sjelljeve të këqija etj.;
- DPT të publikojë raportet vjetore lidhur me indikatorët kundër korrupsionit.

## 2.2 SEKTORIALIZIMI I TVSH

### A. Tvsh në sektorin e përpunimit aktiv (industria fasonit)

Studimi i fundit i paraqitur nga Dhoma e Fasoneve titulluar "Krijimi i një databaze të integruar të industrisë fasonë"<sup>14</sup>, theksoi se në këtë industri operojnë 757 subjekte, 536 janë aktive, ndërsa 221 të tjerët janë pasive. Industria e përpunimit aktiv<sup>15</sup> mbetet e rëndësishme për sa i përket nivelit të punësimit që siguron, ekspertizës teknike që jep në disa profile të sektorit dhe afrimin e komunikimit që nxit mes bizneseve shqiptare dhe atyre të huaja, kryesisht në vendet e BE. Një nga incentivat e rëndësishme të kësaj industrie është procesi i rimbursimit të TVSH-së, ku përballet me vonesa. Qeveria shqiptare është përpjekur për ta promovuar këtë industri nëpërmjet nismave ligjore për lehtësimin e sistemit të TVSH për bizneset lokale dhe të huaja.

#### *Përfaqja ligjore*

Deri në vitin 2009, rimbursimi i TVSH-së së eksportuesve përfundohej brenda 30 ditëve pasi kërkesa ishte paraqitur. Sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, në rastin e eksporteve, eksportuesi ishte i detyruar të paraqiste paraprakisht në administratën tatimore, Deklaratën Doganore të Importit (origjinalen ose kopjen të konfirmuar nga autoriteti doganor i vendit pritës). Vetëm eksportuesit që konsideroheshin me zero risk (ata të cilët vepronin vetëm për eksport, ose që kishin funksionuar për më shumë se tre vite dhe ishin në përputhje të plotë me obligimet ligjore) ishin të përjashtuar nga kjo procedurë. Shumica nuk ishin pjesë e kësaj kategorie, duke u përballur me vonesa të zgjatura dhe kosto shtesë për shkak të kontrollit të shpeshtë tatimor për çdo rimbursimin të TVSH-së, për të siguruar të gjitha dokumentet e kërkuara në vendin pritës. Në mes të vitit 2010, Ministria e Financave lehtësoi këtë proces duke mos kërkuar dokumente të vendit pritës, por vetëm ato që lidhen me doganat shqiptare. Në vitin 2014, qeveria vendosi të marrë në konsideratë analizëm e vlerësimit të riskut dhe për ato eksportues që konsiderohen me zero risk, rimbursimi TVSH-së mund të ekzekutohet pa kontroll tatimor paraprak.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në lidhje me rimbursimin e TVSH-së, një shqetësim i rëndësishëm për këtë industri është norma e TVSH-së për nën-kontraktorët. Në bazë të ligjit të mëparshëm të TVSH-së, shërbimet e nën-kontraktorëve të industrisë fason ishin të përjashtuar nga TVSH-ja.<sup>16</sup> Ky përjashtim u zhvillua për 12 vjet dhe u konsiderua efektiv nga aktorët e industrisë fason. Natyrisht, për të administruar këtë politikë ishte caktuar një procedurë e veçantë transparente, e cila duhej zbatuar nga kontraktori dhe nën-kontraktori. Konkretisht, kjo procedurë ka qenë si më poshtë:

*Mes kontraktorit dhe nën-kontraktorit duhet të nënshkruhet një kontratë në përputhje me Kodin Civil. Nën-kontraktorët duhet të mbajnë një regjistër të veçantë, i cili përshkruan realizimin e punimeve në llogari të kontraktorit. Në këtë regjistër duhet të shënohet identiteti i klientit, emri i tij tregtar, NIPT- i tij, emri dhe mbiemri i administratorit, statusi i tij ligjor, adresa e selisë dhe e degëve mbi të cilat është regjistruar.*

Për çdo kontraktor dhe për çdo veprim që shoqërohet me input dhe output duhet të theksohet:

- Lloji dhe sasia e materialeve që i nënshtrohen përpunimit dhe data e hyrjes;
- Lloji dhe sasia e gjysmë produktit ose produktit të prodhuar dhe data e daljes;

<sup>14</sup> Ky studim i titulluar "Krijimi i një databaze të integruar të industrisë fason" u prezantua në një tryezë të rrumbullakët në Mars 2015. Ky raport nuk është i disponueshëm online. Kjo ishte iniciativa e parë e ndërmarrë nga kjo dhomë, për të krijuar një bazë të dhënash të plotë me bizneset që operojnë në këtë industri

<sup>15</sup> Përpunimi aktiv synon eksportimin e punës, teknologjisë dhe faktorëve të tjerë ekonomikë që bëjnë drejtpërsëdrejti transformimin e thjeshtë apo final në produkte përfundimtare, në mënyrë që ti përdorin ato si produkte në operacionet e tjera të përpunimit, montimit ose konsumit. Procedura e përpunimit aktiv lejon përpunimin e mallrave jo-shqiptare të destinuara për ri-eksport në formën e produkteve të konpesuara, pa kërkuar asnjë pagesë për detyrimet doganore ose duke i rimbursuar ato pas ri-eksportimit

<sup>16</sup> Neni 25/6\*, Pika 1 thuhet: Nënkontraktorët që furnizojnë shërbime të përpunimit të mallrave jo shqiptare, të destinuara për t'u ri-eksportuar për personat e tatueshem të autorizuar mbi bazën e dispozitave të Kodit Doganor për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, përjashtohen nga TVSH-ja

- Në këtë regjistër, stoku i mallrave duhet gjithashtu të evidentohet. Për këtë, inventari është hartuar në muaj;
- Lëvizja e çdo sasive të produkteve gjysmë ose përfundimtare nga nën-kontraktorët për kontraktuesit, duhet të shoqërohet me faturë tatimore pa TVSH, në lidhje me vlerën e shërbimit të kryer.

Në mënyrë që të bëhen pjesë e kësaj skeme (domethënë, të përjashtohen nga TVSH-ja), nënkontraktuesit duhet të paraqesin një kërkesë në departamentin përkatës tatimor dhe pas verifikimit të kërkesës, departamenti i taksave do të mund të lëshojë një dokument që lejon nën-kontraktorin të bëhet pjesë e skemës. Kjo praktikë ka vazhduar deri më 31 dhjetor 2014. Derisa u prezantua dhe filloi zbatimi i ligjit të ri për TVSH-në më 1 janar të vitit 2015, i cili përcakton se:

- a. **Norma e TVSH-së 0%** për përpunimin e mallrave jo-shqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv duhet të zbatohet në faturën e lëshuar nga operatori eksportues, e cila është bashkangjitur deklaratës doganore për ri-eksport të këtyre mallrave.
- b. Në rast se kryerja e shërbimit për përpunimin e mallrave jo-shqiptare të destinuara për ri-eksport, kryhet nga një nën-kontraktor i cili kryen këtë shërbim në emër të kompanisë së përpunimit aktiv (kompani eksportuese), ky shërbim është i tatueshëm me **normë TVSH prej 20%**.

Pavarësisht qëllimit të mirë të këtyre ndryshimeve, këto u shoqëruan me pasoja negative. Së pari, skema e re e taksave ndan regjimin e përpunimit aktiv në dy pjesë. Sipas tij, vlera e shtuar krijuar nga kontraktori i shërbimit të drejtpërdrejtë tatóhet me 0%, ndërkohë që vlera e shtuar që vjen nga nën-kontraktorët është një shërbim i tatueshëm me një normë standarde tatimi prej 20%. Numri i madh i të punësuarve në industrinë Fason vjen për shkak të faktit se këto shërbime janë të bazuar në punën manuale. Një numër i madh i të punësuarve që është i përfshirë në skemën e nën-kontraktorëve, janë të pakualifikuar. Për këtë arsye, rritja artificiale e kostove, i nxit ata të dalin nga kjo industri.

Përveç kësaj, kontratat e nënshkruara midis kontraktorit dhe klientëve të huaj nuk janë gjithmonë dinamike, në përgjithësi jo-afatgjata dhe jo gjatë gjithë vitit kalendarik. Në terma ekonomike, vlera e punës së krahut zë një vend të rëndësishëm në këto kontrata. Ndërsa një pjesë e vlerës së kontratës është duke u rritur vetëm nga aplikimi i TVSH-së, ajo dobëson pozicionin e kontraktorëve të huaj në tregun konkurrues.

Shumë nënkontraktues nuk do të preferonin të dilnin nga tregu i brendshëm. Shumë kontraktues të tjerë nuk do të preferonin të dilnin as nga tregjet e huaja. Prandaj, si një zgjidhje e pjesshme e arritur nga ana e tyre, mund të jetë ai i kryerjes së shërbimit nga nën-kontraktori në mënyrë informale, duke hyrë në lojën e shifrave fiktive.

Sipas skemës së mëparshme, duke pasur parasysh se i tërë zinxhiri i operacioneve të regjimit të përpunimit aktiv ka qenë i përjashtuar nga TVSH-ja, efektet kanë qenë 0 lekë për buxhetin e shtetit. Me skemën e re, problemi konsiderohet si i ndarë në dy faza. Faza e parë, nënkontraktuesit aplikojnë TVSH-në mbi vlerën totale të shërbimit që ata kryejnë dhe kjo TVSH është e zbritshme për kontraktuesin. Faza e dytë, kontraktorit duhet t'i rimbursohet TVSH-ja brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kërkesës.

Direktiva 2006/112 CE<sup>17</sup> BE-së përjashton nga TVSH-ja mallrat e shitura nën regjimin e përpunimit aktiv. Kjo është përfshirë edhe në legjislacionin shqiptar, por vetëm për kontraktorët kryesore, me përjashtim nën-kontraktorët e tyre.

---

<sup>17</sup>Neni 156 DE 2006/112 CE

Në bazë të analizës së mësipërme dhe shqetësimeve të industrisë fason, **NBF rekomandon** për shërbimet e ofruara nga nën-kontraktorët për kontraktorët e regjimit të përpunimit aktiv, tatim me normë TVSH-je prej 0%. Financiarisht, një rekomandim i tillë do të ndikojë pozitivisht tek nën-kontraktorët. Në këtë mënyrë, nën-kontraktorët do të kursejnë një sasi të madhe parash, për aq kohë sa ata nuk kanë TVSH të zbritshme (kjo është për shkak të faktit se nënkontraktuesit nuk kanë shpenzimet e zbritshme). Për këtë arsye ata mund të ri-investojnë paratë për teknologji, për kualifikime të punonjësve, etj.

## **B. Tvsh në sektorin bujqësor**

Bujqësia në Shqipëri, ndryshe nga rajoni, zë një pjesë kryesore në strukturën ekonomike të vendit. Sipas të dhënave të fundit të vitit 2015, të publikuar nga INSTAT, bujqësia renditet e treta për sa i përket peshës ekonomike, duke ndjekur industrinë e shërbimit dhe industrinë e ndërtimit, të cilat renditen respektivisht në vend të parë dhe të dytë. Këto të dhëna zyrtare tregojnë se bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi përbëjnë 20.3% të PBB-së. Pavarësisht ligjit të TVSH-së si një taksë e të gjitha furnizimeve të brendshme dhe të importit, prodhuesit bujqësorë "në heshtje" dhe në marrëveshje me të gjithë palët e tjera, nuk janë subjekt i këtij tatimi. Në përgjithësi, ekonomia bujqësore është parë si total i fermerëve individualë, që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, pa qenë subjekt i tatimit, pavarësisht detyrimeve që lidhen me pronën e paluajtshme.

Skema e kompensimit e fermerëve, e cila ka 8 vjet që është ligjëruar, ka ndjekur të njëjtën linjë me skemën e paraqitur nga Direktiva. Skema e kompensimit të TVSH-së për fermerët është parashikuar në ligjin e TVSH-së, nr 92/2014 dhe ndjek parimet e Direktivës 2006/112 të TVSH-së. Në bazë të këtij ligji, në rast se fermerët shesin prodhimet e tyre në një koleksionist apo një tregtar të regjistruar të TVSH-së, ai / ajo fiton drejtpërsëdrejti rritjen e vlerës me 20% dhe ka të drejtë të plotë për të regjistruar atë si TVSH të zbritshme, që do të thotë kredi në deklaratën e tij mujore të TVSH-së.

Masa e kompensimit prej 20% është e parashikuar me ligj, ndërsa më parë ka qenë 6%. Pavarësisht nga të qenit jo-funksionale, ajo ende mbetet vetëm një skemë. Për më tepër, nuk ka asnjë qëllim ose mundësi, për të sjellë përparim dhe modernizim të sektorit. Ajo ndikon në formalizimin e sektorit thjesht duke e fuqizuar atë me produkte bujqësore dhe blegtorale që qarkullojnë me dokumente të rregullta nga fermeri prodhues për biznesin koleksionist.

Në fillim të zbatimit, interesi ndaj skemës ishte minimal dhe gati i papërfillshëm pasi përqindja e kompensimit për fermerët ishte e përcaktuar praktikisht me 6%. Ky kompensim do të thotë se fermerëve do t'u jepet përsëri TVSH-ja e paguar për inputet bujqësore, e blerë në tregtarët vendas. Fermerët janë të pajisur me një kod fermeri nga drejtoritë rajonale të zhvillimit rural. Kishte mospërputhje mes madhësisë së kompensimit dhe shkallës standarde tatimore, e cila në fakt vazhdon të jetë 20%. Për shkak të kërkesave të vazhdueshme nga ana e biznesit për grumbullimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, në vitin 2015, përqindja e kompensimit u rrit në 20%.

**Lista e produkteve për të cilat skema e kompensimit është zbatuar (Dispozitë e Ministrisë së Financave nr. 19, datë. 19.11.2014)**

**A. Produkte bujqësore**

- Produktet e përgjithshme bujqësore
- Bimë dekorative dhe lule, serat natyrore dhe;
- Produktet e kërpudhave
- Fidanishte (kultivimi i pemëve të reja për shitje) farërat;
- Produktet mjekësore.

**B. Produkte blegtorale**

- Qumështi

**C. Të tjera**

- Mbarështimi i bagëtive;
- Mbarështimi i shpendëve;
- Mbarështimi i lepujve;
- Mbarështimi i bletëve;
- Mbarështimi i krimbit të mëndafshit
- Mbarështimi i kërmijve;

Por, zbatimi i kësaj skeme vazhdon mbetet e vështirë për shkak se është një kusht që çdo fermer duhet së pari të regjistrohet në organet tatimore (jo për qëllime tatimore, por identifikimi), e cila mbetet një pengesë për zbatimin në shkallë të gjerë. Fermerët nuk janë të gatshëm të regjistrohen sepse ata mendojnë ose paragjykojnë që në të ardhmen mund të taten. Shitja e produkteve në rrugët e tyre tradicionale jashtë kësaj skeme ende duket më e sigurt dhe përveç NIPT-it, dokumente të tjera janë të nevojshme, të tilla si marrëveshjet kontraktuale mes të fermerëve dhe koleksionistëve, llogaria bankare e fermerit, prova të statusit të tij si një fermer nga drejtoria për zhvillim rural rajonal.

Direktiva Evropiane 2006/112 / CE, datë 2016/11/28, kapitulli XII, ka përcaktuar:

*"Shtetet anëtare kanë të drejtë të zbatojnë një regjim tatimor të paracaktuar (fiks) për prodhuesit bujqësorë në mënyrë që të kompensojnë shpenzimet për TVSH-në, për mallrat e blera dhe shërbimet e ofruara nga fermerët. Në direktivën e TVSH-së, është parashikuar regjimi i taksave të parapërcaktuar (fiks), shumë vende kanë ndjekur këtë linjë"<sup>18</sup>.*

Fusha e aplikueshme e tij përfshin të gjithë fermerët, veprimtaria e të cilëve nuk është duke u bërë objekt i personit të tatueshëm ose që zotëron një sipërfaqe prej 1ha. Për shembull, në Holandë, numri i fermerëve të përfshirë në këtë skemë është i ndryshëm. Në Francë vetëm 16% e fermerëve janë të përfshirë në këtë skemë, në Holandë 50%, ndërkohë që në Gjermani 90%.<sup>19</sup> Përfshirja e këtij grupi të prodhuesve bujqësor në këtë skemë empirike është bërë për shkak të vështirësisë ose pamundësinë e përfshirjes së tyre në një regjim të thjeshtuar tatimor apo edhe normal. Qëllimi i përfshirjes është duke u dhënë atyre kompensim të drejtë, por edhe kundër një skemë që ka kërkesat më të ulëta për sa i përket shpenzimeve administrative. Direktiva parashikon që kompensimi mund të paguhet direkt nga blerësi i një personi të tatueshëm, ose nga institucione të administratës publike. Në Francë, rimbursimi

<sup>18</sup> [eur-lex.europa.eu](http://eur-lex.europa.eu) > EUROPA > EU law and publications > EUR-Lex (D2006/112/CE e datës 28.11.200

<sup>19</sup> [Federata Europiane e Konsulencës Bujqësore \(EFAC\)](http://www.efac.net/?p=90) Link: <http://www.efac.net/?p=90>



është bërë nga administrata tatimore vendore, me paraqitjen e një deklarate vjetore të fermerit ndërsa në Itali, Belgjikë dhe Gjermani direkt pas çdo shitje, nga blerësit.

Direktiva Evropiane D2006/ 112 / CE, datë 28.11.2006, neni nr. 98, parashikon që shtetet anëtare mund të aplikojnë një ose dy norma tatimore të reduktuara. Reduktimi i normave tatimore zbatohen veçanërisht për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të renditura në Shtojcën III.

Bazuar në situatën e përshkruar më sipër, anëtarët e Forumit Kombëtar të Biznesit rekomandojnë që sektori i bujqësisë, të tatonet në një normë të reduktuar të TVSH-së, siç ndodh në vende të tjera të Bashkimit Evropian. Siç u përmend më sipër, në lidhje me shkallën e reduktuar tatimore, neni nr. 98 i Direktivës Evropiane për TVSH-në, ka parashikuar zbatimin e këtyre shkallëve<sup>20</sup>. Në shumicën e vendeve të BE-së, për produktet ushqimore është aplikuar në vazhdimësi një shkallë e reduktuar e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Në këtë grup të produkteve janë të përfshira dhe dominojnë ato me origjinë bujqësore, ku produktet e qumështit dhe nënprodukteve të tij, klasifikohen në të njëjtën kohë nga të gjitha shtetet anëtare në këtë kategori.

Normat e tatimit mbi shitjen e TVSH-së, në disa vende (në zona të ndryshme gjeografike), të quajtura të reduktuar dhe super-reduktuar.

Belgjikë 6%,	Republika Çeke 15%
Gjermani 7%,	Spanjë 4% dhe 10%
Irlandë 4,8%,	Itali 4% dhe 10%
Luksemburg 3%,	Qipro 5%,
Malte 0%	Holandë 6%,
Austri 10%,	Poloni 5% dhe 8%
Portugali 6%,	Slloveni 8,5%.

Bazuar në analizën e mësipërme, NBF **rekomandon Ministrisë së Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrë në konsideratë zbatimin e reduktimit të TVSH-së për sektorin e bujqësisë nga 20% në 10%**. Kjo ulje do të ulë nivelin e informalitetit në këtë sektor. Përveç kësaj, një TVSH e reduktuar do të rrisë interesin e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri (Aktualisht ne kemi shkallën më të lartë në Evropën Lindore). Ne nuk mund të flasim për ndikimin e drejtpërdrejtë të reduktimit të TVSH-së, për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare. Megjithatë, kjo do të jetë një nxitje shumë pozitive për sektorin e bujqësisë.

## C. Tvsh në sektorin e turizmit

Sektori i turizmit është vlerësuar sot si tregu më potencial, lidhur me sfidat e rritjes ekonomike të vendit. Ndikimi i saj arrin 7% të PBB-së, ndërkohë që në shumat totale në 12%<sup>21</sup>. Turizmi është identifikuar si sektori i zhvillimit ekonomik që ka një lidhje të fortë me punësimin, duke prekur këtë të fundit në tri nivele:

- a. Punësimi i drejtpërdrejtë në këtë sektor (vija e parë e shërbimeve të udhëtimit)
- b. Punësimi në sektorin lidhur direkt me furnizimet, mallrat dhe shërbimet e turizmit (linja e dytë)
- c. Punësimi në tregje të ndikuar pozitivisht nga zhvillimi i turizmit.

<sup>20</sup> [https://ec.europa.eu/taxation\\_customs/sites/taxation/files/docs/body/vat\\_rates\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/taxation_customs/sites/taxation/files/docs/body/vat_rates_en.pdf).

<sup>21</sup> Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA)

Turizmi shqiptar është përballur me kosto të mëdha që ndikojnë në dëmtimin e konkurrencës dhe zhvillimin e saj. Sfidat më të rëndësishme mbeten infrastruktura e dobët, sezon të shkurtër, duke filluar nga 45 në 60 ditë, niveli i lartë i informalitetit dhe taksat deri në 300% më të larta se të rajonit.

Në bazë të studimit të fundit të kryer nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA), aktualisht ka 1200 kompani që operojnë në turizëm (agjenci, hotele, restorante, kampe dhe fshatrat turistike). Duke iu referuar të dhënave nga ATA, kontributi i TVSH-së së vendosur mbi turizmin në buxhetin e shtetit rezulton të jetë 1.5-2 milion Euro. Gjithashtu, një reduktim i TVSH nga 20% në 10% do të rriste kërkesën me 12%.

### ***Përqsja ligjore***

Në 2014, Ministria e Turizmit hartoi Paketën e Zhvillimit të Turizmit, në kuadër të zhvillimit strategjik të këtij sektori. Në mesin e 54 masave të konsideruara si të domosdoshme, vlen të përmendet Masa nr. 26 që deklaron në mënyrë të qartë: Rishikimi i TVSH-së së hotelit nga 20% në 10% (Direktiva e BE 006/112/EC dhe 2009/47/EC). Por në të vërtetë, kjo masë nuk u zbatua kurrë. Situata në rajon, përsa i përket normës së tatimit të TVSH-së, paraqitet si më poshtë: Greqi-6.5%, Mali i Zi-7%, Maqedonia-5%, Kroacia-13%, Turqia-7%, Bullgaria- 7%, Serbia -8%, Sllovenia-8.5%, Rumania, 9%. Bazuar në këto të dhëna, është e qartë se Shqipëria ka përqindjen më të lartë të TVSH-20%.

Gjatë RBF, ndër çështjet thelbësore të ngritura, ishte ajo e TVSH-së në sektorin e turizmit, e cila është aktualisht në 20%. Kjo normë e TVSH-së mbetet një barrë e jashtëzakonshme për operatorët e këtij sektori. Shqipëria mbetet vendi me normën më të lartë të TVSH-së në sektorin e turizmit, duke përkeqësuar konkurrencën në rajon. Në strategjinë e saj për sektorin e turizmit, qeveria shqiptare ka parashikuar ndërtimin e 250-300 hoteleve të reja me një kapacitet prej 80-100 dhoma, të cilat në fakt nuk u ndërtuan kurrë. Kjo erdhi për shkak të taksave shumë të larta të cilat vendosën këtë sektor në rrezik dhe bënë të pamundur që investimi fillestar të kthehej shpejt. Për këtë arsye, sektori i turizmit shqiptar u përkeqësua dhe rajoni u bë avantazhues si rezultat i nismave të qeverive përkatëse.

Gjatë RBF, përfaqësuesit e sektorit të turizmit kërkuan një ulje të TVSH-së së turizmit nga 20% në 10%. Ndërsa nga 1182 subjekte, 880 prej tyre janë me një kapacitet prej 30.000 shtretërish të cilat duhet të kontribuojnë në të paktën dyfishimin e kësaj shifre. Rezultati i llogaritjes së reduktimit të TVSH-së me 10%, mund të kontribuojë në buxhetin e shtetit mbi 2 herë më shumë se kontributi në 2013 nga i gjithë sektori me normën 20% të TVSH-së (në mënyrë specifike qeveria do të mbledhë 3.285 milionë Euro). Llogaritjet janë si më poshtë:

3000 shtretër x 20% (norma mesatare e shfrytëzimit) x 365 netë x 15 euro/shtrat në natë (çmimi mesatar) x 10% (TVSH), prodhojnë në total 3.285 milion Euro TVSH të mbledhur vetëm nga hotelet. Sipas këtyre të dhënave, ulja e TVSH-së në 10% me të njëjtin çmim për shtrat në natë do të grumbullojë 15 milionë euro vetëm nga hotelet. Ky fakt është një tregues i shkallës së lartë të informalitetit dhe si pasojë e nivelit të ulët të taksave të mbledhura nga ky sektor.

Para së gjithash, informaliteti do të zbutet; pra një numër i madh i operatorëve aktualisht të paregjistruar do të bëhen formal dhe kjo do të japë një rritje në të ardhurat e buxhetit të shtetit si më sipër tregohet (nga 2 milionë në afërsisht 3 milion euro). Për më tepër, konkurrenca e sektorit të turizmit në Shqipëri do të rritet në drejtim të rajonit. TVSH-ja e reduktuar në 10% do të rrisë kërkesën (një ulje të çmimit me 10% do të rrisë kërkesën me 12% (ATA, 2016).

**NBF rekomandon** Ministrinë e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Turizmit, të reduktojë normën e TVSH-së për sektorin e turizmit nga 20% në 10%. Ky propozim është në përputhje me dispozitat e Direktivës së Këshillit Evropian 2006/112 i datës 28 nëntor 2006, "Për sistemin e përbashkët të TVSH-së", dhe me atë të Direktivës së 2009/47/EC.

## 2.3 INFORMALITETI

Çështja e informalitetit rezultoi të ishte shqetësimi kryesor i shprehur gjatë RBF, ku përfaqësuesit e biznesit bënë të qartë shqetësimet e tyre lidhur me përjasjen jo proaktive të qeverisë për reduktimin e këtij fenomeni. Një nga çështjet e informalitetit të diskutuara gjatë RBF, ishte pengesa në aktivitetin normal që bizneset e çregjistruara u bëjnë atyre të regjistruara më saktë rritjen e konkurrencës së pandershme. “*Konkurrencë e madhe nga bizneset e tjera të paregjistruara*” u pranua të ishte një nga sfidat kryesore të 400 bizneseve të anketuara vitin e kaluar nga NBF<sup>22</sup>. Përhapja e informalitetit (të gjitha tipologjitë e informalitetit) u pranua nga pjesëmarrësit e RBF si e dëmshme për konkurrencën e ndershme, duke shtyrë biznesin formal në ekonominë jo formale si një nga mënyrat më të lehta për të bërë biznes, duke reduktuar kështu të ardhurat fiskale në buxhetin e shtetit, pra uljen në mënyrë serioze të shpenzimeve për shërbime publike. Për të reduktuar këtë fenomen, pjesëmarrësit e RBF paraqitën disa propozime bazike të cilat u evidentuan pas analizimit të shkaqeve të informalitetit dhe përjasjeve jo efektive të aksioneve të kryera nga qeveria. Këto propozime janë paraqitur si më poshtë dhe lidhen gjithashtu me hapat përkatës për tejkalimin e problemeve të hasura.

### A. Aksionet e qeverisë kundër informalitetit

Raporte dhe studime të ndryshme ndërkombëtare tregojnë se ekonomia informale në Shqipëri parashikohet të jetë 30 deri në 50%<sup>23</sup>. Sipas raportit të fundit të KE, Shqipëria ka bërë progres në lidhje me “luftën kundër informalitetit”<sup>24</sup>. Aksionet e forta të qeverisë të nisura vitin e kaluar<sup>25</sup>, të cilat synonin uljen e nivelit të informalitetit, dhanë disa rezultate fillestare pozitive. Ndërmjet tyre mund të përmendet regjistrimi i bizneseve, ku afërsisht 37.000 nga 150.000 u regjistruan rishtazi falë këtyre aksioneve dhe kjo gjë çoi në rritjen e numrit të punonjësve të deklaruar. Megjithatë, ky aksion u shoqërua dhe me rezultate negative. Mijëra biznese kthyen statusin e tyre nga aktiv në pasiv, ose filluan procedurat e mbylljes<sup>26</sup>.

Sipas të dhënave të raportuara nga Ministria e Financave rreth indikatorëve fiskalë të 2015, 2.4 miliardë ALL ose 8.9% u mblodhën më pak të ardhura nga taksat në krahasim me vitin 2014<sup>27</sup>. Sipas të dhënave të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), borxhi tatimor i më shumë se 100 milionë ALL është ndarë në një numër relativisht të lartë taksapaguesish (29.000). Gjithashtu, numri i tatimpaguesve që ka ndërprerë aktivitetin e tyre ka tejkaluar 100.000.

<sup>22</sup> [http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)

<sup>23</sup> Schneider, Friedrich, 2012, Vlera e Shtuar e Aktiviteteve të Nëndheshme: Madhësitë dhe Matjet e Ekonomive të Hijes të 110 Shteteve në të gjithë Botën, Johannes Kepler Universiti i Linz-it, Mimeo. <http://ftp.iza.org/dp6423.pdf>

<sup>24</sup> Progresi i KE, 2016. [http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)

<sup>25</sup> Ministria e Financave. <http://www.financa.gov.al/al/newsroom/lajme/aksioni-kunder-informalitetit-prezantohet-faza-e-dyte&page=3>

<sup>26</sup> Raporti Vjetor. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Kapitulli IV, pika 4.2.1

<sup>27</sup> <http://www.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore/statistika-fiskale-mujore>

Aksionet nuk prodhuan rezultatet e pritura në reduktimin e nivelit të informalitetit si dhe të vlerës së pritur në të ardhurat e buxhetit të shtetit, duke treguar një përjasje jo të duhur dhe jo eficient në lidhje me aksionin kundër informalitetit të administratës tatimore. Qeveria shqiptare doli me deklaratën “ne kemi një strategji të qartë për zvogëlimin e informalitetit”, por deri më tani, asnjë strategji nuk është publikuar, në vend të saj ka vetëm disa deklarata zyrtare të Ministrit të Financave dhe Kryeministrit. Fillimi i aksioneve të shpeshta kundër informalitetit (shumicën e kohës zyrtarët publikë përdornin fjalën “luftë” në vend të reformës) pa një strategji të qartë dhe konsultim me grupet kryesore të interesit, e bëri të dyshimtë arritjen e rezultateve efektive.

Aksioni kundër informalitetit dhe ndëshkimet jo proporcionale të vendosura mbi sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), rriti frikën e komunitetit të biznesit. Përdorimi i vazhdueshëm i fjalës “luftë” apo “aksion” në vend të reformës, ngjalli debat ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë. Ia vlen të thuhet se në një mjedis fiskal të qëndrueshëm, pritshmëritë pozitive janë të dyshimta kur të gjitha strategjitë afatshkurtra dhe afatmesme përmbliidhen me termin justifikues “*aksion*”. Qëndrueshmëria është e arritshme vetëm me një program reforme të vërtetë, i cili mbështet dhe koordinon të gjithë stakeholders-at, zbatueshmëria e të cilit nuk mbështetet në kohëzgjatje të shkurtër por është në të njëjtën kohë afatgjatë dhe e balancuar. Aksioni kundër informalitetit nuk u aplikua njësoj për të gjithë komunitetin e biznesit. Fokusi më i madh ishte tek mikrobizneset dhe ato të vogla, sesa tek bizneset e mëdha. Për këtë arsye nuk u rritën të ardhurat vjetore të buxhetit të shtetit, por pati efektivitet vetëm në fushën e vetëpunësimit. Për rreth 4 muaj pothuajse të gjitha strukturat e administratës tatimore ndërmorën rreth 180 mijë inspektime tatimore, ku vetëm në Tiranë numri i bizneseve të inspektuara arriti 55.000<sup>28</sup>. Ky numër i madh i inspektimeve (mesatarisht 45.000 në muaj), tregoi se pothuaj të gjitha inspektimet ishin në bizneset e vogla, ndërsa inspektimet në biznesin e madh ishin vetëm 15<sup>29</sup>.

Gjatë RBF, përfaqësuesit e turizmit ngritën një çështje urgjente, nivelin e lartë të informalitetit në bregdetin shqiptar të lidhur me infrastrukturën e akomodimit të ofruar për turistët nga familjet. Kjo do të thotë që godinat familjare me kapacitet me rreth 10 dhoma nuk janë të regjistruara si biznese dhe dëmtojnë operatorët e regjistruar të turizmit. Kjo tregon rolin e dobët të qeverisë qendrore për të normalizuar këtë situatë.

#### **NBF rekomandon:**

- Ministrinë e Financave që të publikojë dhe të konsultojë strategjinë paraprake në lidhje me reduktimin e informalitetit në Shqipëri dhe të publikojë një axhendë zyrtare;
- DPT duhet që të realizojë kontrollet tatimore tek të gjithë bizneset pa dallim nga madhësia e tyre duke u bazuar në analizën e vlerësimit të riskut dhe në bashkëpunim me MF duhet që të ndërmarrë fushata sensibilizuese për t'i ndihmuar ato në procesin e gjatë të formalizimit;
- Në lidhje me informalitetin në turizëm, NBF rekomandon që kjo problematikë të menaxhohet nga qeveria lokale. Kjo e fundit duhet të identifikojë çdo apartament/ndërtesë

<sup>28</sup> <https://www.tatime.gov.al/sq-al/us/Documents/RAPORTI%20DPT%202015.pdf>

<sup>29</sup> Id.

që shërben për qëllime ekonomike dhe të regjistrojë të gjitha ato që përdoren për shërbime hotelerie duke vendosur një shenjë të dukshme në godinën e tyre në mënyrë që të jenë transparente dhe të tregojnë se këto ndërtesa janë të regjistruara dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.

## B. Ndarja e tatimit mbi fitimin në sistemin tatimor

. Sipas përkatësisë të regjimit tatimor, sipërmarrësit klasifikohen në këto kategori:

- Taksapaguesit e tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH);
- Taksapaguesit e tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin dhe tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH);
- Taksapaguesit e tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin.

Gjatë diskutimit në RBF, pjesëmarrësit ngritën çështjen e ndarjes së tatimit mbi fitimin si një faktor kyç që do të detyrojë tatimpaguesit të kalojnë në sektorin informal. Regjimi tatimor i lidhur me tatimin mbi fitimin e biznesit (tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi fitimin e thjeshtëzuar) është i pavarur nga struktura e organizatës ose nga drejta ligjore e një personi me statusin e sipërmarrësit. Xhiroja që realizohet gjatë një periudhe tatimore (vit kalendarik) është përcaktuesi kryesor.

### *Përfaqësja ligjore*

Bazuar në të dhënat e administratës tatimore, 91 % e bizneseve gjenerojnë më pak se 2 milion ALL, ndërsa vetëm 6 % gjenerojnë xhiro në intervalin 2-5 milion ALL. 3 % e tyre janë midis intervalit 5-8 milion ALL.

Deri në 2015-ën ekzistonte një nivel i tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin në bizneset e vogla dhe ishte 7.5% për ato biznese me qarkullim prej 2-8 milion ALL, ndërsa bizneset me qarkullim prej 0-2 milion ALL taksoheshin me një shumë fikse prej 25.000 ALL në vit. Me ndryshimet e hyra në fuqi rishtazi në 2016 tatimi i thjeshtëzuar mbi fitimin ndryshoi si në tabelën më poshtë.

Qarkullimi vjetor (ALL)	Tatimi 2015
Deri në 2 milion	Pagesë fikse vjetore (ALL) 25,000
2-8 milion	7.5

Qarkullimi vjetor (Lek)	Tatimi 2016
Deri në 5 milion	0 %
5-8 milion	5 %
Më shumë se 8 milion	15 %

Sipas këtij kategorizimi, biznesi përpiket të qëndrojnë në atë fashë të xhiros që është më me leverdi. Në këtë mënyrë biznesi bën përpjekje për të qëndruar brenda fashës që ka normën më të ulët, atë të tatimit 0%, pra poshtë xhiros 5 (pesë) milion ALL. Specifikisht, kur bizneset u pyetën se çfarë i pengonte për të operuar në transparencë të plotë, ata listuan ndërmjet faktorëve kryesorë “normën tatimore për xhiron e bizneseve të mëdha”. Kjo gjë u pranua si një pengesë madhore nga 71% e bizneseve të anketuara<sup>30</sup>.

**NBF**, duke e parë çështjen nga pikëpamja e taksapaguesit **rekomandon** administratën tatimore të vendosë tek bizneset me qarkullim nga 2 deri në 8 milion ALL vetëm një taksë të thjeshtëzuar fitimi prej 5%. Ky indikator tregon se propozimet e reja të intervaleve nuk do të dëmtojnë kategorinë e vogël të bizneseve por do të ulin nivelin e përgjithshëm të informalitetit. Ky rekomandim do të ulë në mënyrë indirekte nivelin e informalitetit dhe do të rrisë në mënyrë direkte të ardhurat në buxhetin e shtetit me rreth 1.5 miliardë Lek.

### C. Ndarja e TVSH-së në Shqipëri

Në RBF-në e mbajtur në Shtator 2016, përfaqësuesit e biznesit të madh dhe të mesëm prekën çështjen e pragut të lartë të vlerës për t'u klasifikuar si taksapagues të TVSH. Ata shtuan se ky prag i lartë nxit bizneset që janë subjekt i TVSH të shndërrohen në informale. Bizneset e regjistruar si taksapagues të tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin (0%), kundrejt bizneseve të mëdha të cilat paguajnë tatim mbi fitimin (15%) nuk janë të interesuara për të marrë një faturë tatimore për çdo transaksion dhe në këtë mënyrë ndërmarrin veprime jo formale me ndërgjegje të plotë. Së pari, ata preferojnë të mbajnë pozicionin e tyre të favorshëm fiskal, normën tatimore 0% për tatimin e thjeshtëzuar mbi fitimin dhe së dyti, për të ruajtur pozicionin e preferuar si një lojtar që nuk paguan TVSH. Shmangia nga regjistrimi si lojtar i TVSH-së ndiqet nga shmangia e detyrimeve të tjera të lidhura me indikatorët e xhiros pasi tatimi mbi fitimin dhe taksa të tjera tregohen nga kategorizimi i statusit të biznesit.

Një situatë e tillë e cila ka vite që diskutohet inkurajon transaksionin e të mirave dhe shërbimeve pa asnjë dokument fiskal (fatura tatimore, librat e blerjes dhe shitjes dhe deklaratat tatimore) duke krijuar një situatë të qartë evazioni tatimor.

Prandaj, **NBF rekomandon** se pragu i TVSH-së, nga 5 milion ALL duhet të jetë 2 milion ALL. Në të njëjtën kohë, institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë llojet speciale të aktiviteteve ekonomike si punët artizanale apo të llojeve të ngjashme, të cilat pavarësisht nivelit të xhiros marrin materialin bruto nga natyra pa pasur mundësinë për të kredituar TVSH-në për blerjet e mundshme.

### D. Kostot e larta të biznesit

Gjatë RBF, përfaqësuesit e biznesit pranuan se në lidhje me taksat e larta ka dhe kosto administrative të cilat krijohen si rezultat i nivelit të lartë të burokracisë apo të disa tarifave të tjera për shërbime të ndryshme të kryera nga institucionet publike. Këto tarifa nuk janë pjesë e ligjit por përbërja e tyre po dëmton buxhetin shtetëror. Çështja e burokracisë është identifikuar si një nga tri problemet kryesore të raportuara nga biznesi për 2015<sup>31</sup>.

<sup>30</sup> Forumi Kombëtar i Biznesit. (2016) Këndvështrimi i Forumit Kombëtar të Biznesit mbi çështjen e informalitetit në Shqipëri.

[http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)

<sup>31</sup> AMCHAM- Indeksi i Biznesit, 2015-2016. [http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI\\_2015\\_2016\\_en.pdf](http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI_2015_2016_en.pdf)

Një nga tarifatat/pagesat e kërkuara për t'u paguar për çdo shërbim ishte ajo e skanimit të deklarimeve doganore të cilat vlerësohen afërsisht me 9 milion Lek në vit.

Kontrata skanuese e *Rapscan* parashikon pagesën e 22 eurove për çdo deklaram doganor pavarësisht nëse skanohet apo jo. Përfaqësuesit e biznesit dhe pjesëtarët e forumit thanë se kjo pagesë rrit kostot e tyre; për më tepër kjo pagesë është e nevojshme të kryhet edhe kur të mirat kthehen prapa për arsye të ndryshme.

Kjo gjë është jashtëzakonisht e rëndësishme veçanërisht për të mirat që rrezikojnë të prishen për shkak të kushteve specifike që duhet të mbahen. Në këtë mënyrë, të dyja palët në këtë transaksion (zyrat doganore dhe bizneset) janë më të gatshme ta zgjidhin këtë çështje përmes rryshfetit. Ia vlen të përmendësh se biznesi bën këtë zgjidhje i detyruar nga kushtet e vëna nga Dogana. Sipas një studimi të kryer nga ACER, kjo e fundit listohet si një nga doganat më të korruptuara në botë<sup>32</sup>.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike zakonisht i mbifaturon bizneset duke manipuluar burimin e furnizuesit sekondar me voltazh të ulët dhe duke krijuar një mospërputhje të sasisë së energjisë së konsumuar dhe asaj të faturuar. Bizneset janë të detyruara që të paguajnë për elektricitetin shumë më 14 ALL/kw, në krahasim me tarifën prej 11 ALL/kw që duhej të paguanin. Në këtë mënyrë, çdo vit bizneset paguajnë 16 milion ALL shtesë për faturat e energjisë.

Kostot e stampave fiskale janë rritur tre here, që pas dhënies së koncesionit tek Sicpa Security Solutions, Albania”, sh.p.k.

### **Niveli i taksave direkte dhe indirekte**

Siç u diskutua gjatë RBF një tjetër faktor i rëndësishëm që inkurajon biznesin të jetë pjesë e informalitetit është niveli i lartë i taksave. Kjo është pranuar nga 66% e bizneseve të anketuara nga NBF në 2015<sup>33</sup> dhe së fundmi nga Dhoma Amerikane e Tregtisë<sup>34</sup>. Po të bëhet një krahasim i normave të taksave dhe tatimeve me vendet e Ballkanit Perëndimor, rezultojnë se norma e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) është e krahasueshme. Duke pasur parasysh këtë situatë, bizneset në Shqipëri pranojnë se në përgjithësi niveli i taksave është i krahasueshëm por ato perceptohen si të larta nga këndvështrimi i kostove dhe tarifave (vetëm kosto ekstra e skanimit të deklaratave doganore llogaritet të jetë rreth 9 milion Euro në vit.) Një tjetër çështje e diskutuar në RBF është niveli i taksave në sektorë të ndryshëm çka konsiderohet si një sfidë në Shqipëri.

Tabela 1: Normat e Taksave në Ballkanin Perëndimor

<sup>32</sup> ACER, Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit 2016.

[http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/CAR\\_Albania\\_2016/Raporti\\_i\\_Vleresimit\\_te\\_Korrupsionit\\_2016.pdf](http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/CAR_Albania_2016/Raporti_i_Vleresimit_te_Korrupsionit_2016.pdf)

<sup>33</sup> Forumi Kombëtar i Biznesit. (2016) Këndvështrimi i Forumit Kombëtar të Biznesit mbi çështjen e informalitetit në Shqipëri.

[http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)

<sup>34</sup> AMCHAM - Indeksi i Biznesit 2015-2016. [http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI\\_2015\\_2016\\_en.pdf](http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI_2015_2016_en.pdf)

Vendi	TVSH		Tatim Fitimi (%)	Tatim mbi të Ardhurën Personale (%)
	Limiti (euro)	Norma (%)		
Shqipëria	35 670	20	15	23
Maqedonia	32 460	18	10	10
Serbia	68 000	20	15	15
Mali i Zi	18 000	19	9	15
Kosova	30 000	18	10	10
Bosnja dhe Hercegovina	25 000	17	10	10

Burimi: Stafi i FMN ; Eurostat, 2016

Megjithatë sipërmarrësit e kompanive të ndërtimit këmbëngulin se taksa vendore e quajtur *taksa mbi infrastrukturën* është përkeqësuar. Nga niveli 4% mbi koston e ndërtimit kjo taksë është rritur në nivelin 8% (dyfishuar) dhe aplikohet në një bazë më të lartë që është çmimi i shitjes. I njëjti shqetësim vlen edhe për TVSH në sektorin e turizmit.

Përfaqësuesit e bizneseve që kanë marrë pjesë në **RBF japin rekomandimet e mëposhtme:**

- Rishikimin e normës së tatim fitimit dhe kthimin në nivelin e mëparshëm prej 10%, i krahasueshëm me vendet fqinje;
- Rishikimin e nivelit të taksës që ndikon mbi infrastrukturën e cila bie në kundërshtim me parimet e taksimit duke qenë se aplikohet mbi çmimin e shitjes në të njëjtën mënyrë si një taksë mbi konsumin (si një TVSH e dytë e fshehur, por në normën 8%).

## E. Paqëndrueshmëria dhe cilësia e legjislacionit

Gjatë RBF, paqëndrueshmëria e legjislacionit që ka një ndikim në aktivitetin e përditshëm të bizneseve është diskutuar si një çështje madhore. Ndryshimet e shpeshta ligjore pengojnë komunitetin e biznesit të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin për shkak të përditësimit të vonuar të këtyre ndryshimeve. Kjo është pranuar nga një pjesë e konsiderueshme e bizneseve të anketuara nga NBF mbi çështjen e informalitetit në gusht të 2015 (53% e bizneseve të anketuara e pranojnë këtë gjë)<sup>35</sup>. i njëjti konkluzion u prezantua dhe në studimin e Këshillit të Investimeve, vitin e kaluar.<sup>36</sup>

Tabela e mëposhtme tregon numrin e neneve kryesore të ligjit mbi procedurat e taksimit të përmirësuara në 2009. Duhet të qartësohet se ndryshimi më i madh është ai në fund të vitit 2016 ku një pjesë e ndryshimeve kishin të bënin me shfuqizimin e neneve të miratuara një vit më parë. Kështu siç u konstatua nga moment i hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 9920 në 19 Maj 2008 "Mbi procedurat e taksimit në Republikën e Shqipërisë", 179 nene të këtij ligji janë ndryshuar.

<sup>35</sup> Forumi Kombëtar i Biznesit. (2016) Këndvështrimi i Forumit Kombëtar të Biznesit mbi çështjen e informalitetit në Shqipëri.

[http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)


<sup>36</sup> Informaliteti, Sfidë e përbashkët Qeveri-Sipërmarrësve, Dhjetor 2015. <https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/Dokument-Pune-mbi-Infomalitetin.pdf>



Ja vlen të përmendet se ndryshimet më të mëdha janë bërë gjatë tre viteve të fundit, u përmirësuan 126 nene ose 70% e tyre. Këto ndryshime filluan në vitin 2014 dhe në fund të periudhës së aksionit kundër informalitetit. Në përgjithësi penalitetet janë pesëfishuar në mënyrë agresive për taksapaguesit. Nuk ka pasur diskutime paraprake me komunitetin e biznesit për këto ndryshime në ligj.

Në vazhdim të këtyre ndryshimeve, në 2016 shumica e neneve që përfshinin masat e penaliteteve u ndryshuan ose u modifikuan për shkak të inefektivitetit të tyre. Kjo është një rritje artificiale në koston e menaxhimit të biznesit dhe kërkon vazhdimisht shërbime ekstra nga ekspertët e jashtëm. Ndryshimet më drastike të 2015 që fillimisht ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (vendimi nr. 33, datë 8.06.2016), u bënë pa diskutime paraprake si me përfaqësues të biznesit dhe të administratës tatimore (platformat publike – private). Nuk pati vetëm pasoja të mëdha financiare por ndikoi edhe në përkeqësimin e klimës së biznesit.

Tabela1: Ndryshimet në nenet e ligjit “Mbi Procedurat e Taksimit”



Burimi: Kalkulimet e autorit

Duke marrë në konsideratë çështjet e mësipërme lidhur me paqëndrueshmërinë e legjislacionit dhe mungesën e diskutimeve paraprake me komunitetin e biznesit, **NBF rekomandon:**

- Duhet t’i lihet më shumë kohë komunitetit të biznesit kur bëhet fjalë për hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve;
- Ligjvënësit duhet të krijojnë më shumë hapësirë për debat dhe të promovojnë diskutimet në tavolina të rumbullakëta me pjesëmarrjen e anëtarëve të parlamentit dhe ekspertëve;
- Do të ishte pozitive rritja e qëndrueshmërisë së legjislacionit duke bërë ndryshime aty ku është e nevojshme.

## F. Mungesa e shërbimeve publike për taksat që paguhen

Gjatë RBF, pjesëmarrësit diskutuan rreth mungesës së shërbimeve publike dhe cilësinë e ulët të atyre që ofrohen. Specifikisht, në studimin e informalitetit që NBF ka bërë në vitin 2015, bizneset e anketuara pranuan se një faktor i rëndësishëm që do të inkurajonte pagimin e plotë të taksave është përdorimi i të ardhurave të mbledhura nga taksat për financimin e shërbimeve të rëndësishme publike (67 %).

Çdo taksë e paguar duhet të konvertohet në ofrimin e një shërbimi apo të mire publike. Ndërkohë që pjesa më e madhe e taksapaguesve janë kontribuues të rregullt; nga ana tjetër

ata nuk shohin asnjë përfitim të marrë në këmbim. Rënia e cilësisë së shërbimeve publike i dekurajon taksapaguesit për të qenë në përputhje të plotë me rregullat e taksimit.

Bazuar në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Financave për vitin 2015, ishte krijuar një deficit prej 3.7 % ose 13.3 miliard ALL. Ky deficit bëri që shpenzimet buxhetore të uleshin me 4,2%, ose me një shumë totale prej 19 miliardësh. Për 11 muaj në vitin 2016 nga të ardhurat e taksave u krijua një deficit prej 1% ose 3.6 miliard ALL më pak. Për sa i përket shpenzimeve ato janë realizuar 6.9% më pak se objektivi<sup>37</sup>.

Bazuar në të dhënat e RBF-ve, **NBF rekomandon** qeverisë:

- Krijimi i një sistemi të vazhdueshëm ose periodik të sistemit të monitorimit në lidhje me përdorimin e fondeve publike nga qeveria;
- Organizimi i sondazheve me grupe të ndryshme të interesit për rezultatet e arritura dhe ato të pritshme në lidhje me përdorimin e fondeve publike.

### **G. Besimi i ulët i komunitetit të biznesit ndaj institucioneve apeluese**

Gjatë diskutimeve në RBF, pjesëmarrësit e konsideronin korrupsionin si një çështje që duhet të merret menjëherë parasysh për aq kohë sa anëtarët e tyre përballen me inspektorë të tatimeve dhe doganave apo inspektorë të tjerë të cilët kërkojnë vazhdimisht ryshfet. E njëjta gjë ndodhi edhe me përfaqësuesit e sistemit gjyqësor. Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve adresuan këtë çështje e cila mbetet një pikë kritike në marrëdhëniet mes qeverisë, bizneseve dhe individëve. Nëpunësit zyrtarë i kërkojnë bizneseve ryshfet kundrejt zgjidhjes së shpejt të problemeve të tyre. Në sondazhin e fundit që NBF realizoi gjatë periudhës Gusht-Shtator të vitit të shkuar, nga 400 biznese 38% e tyre deklaruan se nëpunësit e tatimeve kërkojnë fillimisht për ryshfet në mënyrë që të lehtësojnë procesin e inspektimit.

Pjesa më e madhe e studimeve konfirmojnë se ekziston një lidhje negative mes korrupsionit dhe rritjes ekonomike duke theksuar rëndësinë e përmirësimit të "qeverisjes" si një element themelor në programet e suksesshme të reformave ekonomike. Besueshmëria e institucioneve është në rënie kur zyrtarët publikë bien në kthetrat e korrupsionit.<sup>38</sup> Korrupsioni shfaqet në forma të ndryshme por ato më të ndjeshmet janë korrupsioni i nëpunësve të Doganave ose Tatimeve.

Komuniteti i biznesit heziton për të apeluar vendimet e administratës tatimore apo institucioneve të tjera publike për shkak të mungesës së besimit në këto institucione. Kjo mungesë e besimit është konfirmuar në një tjetër studim të zhvilluar nga Këshilli i Investimeve i cili tregon se nuk ka besim mes palëve<sup>39</sup>. Në mënyrë të veçantë, ky studim tregon se vetëm 5% e ankesave të marra nga bizneset kanë rezultuar të jenë të suksesshme për to. Në muajt e fundit, e njëjta dukuri është shfaqur edhe brenda seancave në gjykatën administrative. Ekziston një qasje tjetër e kësaj gjykate, ndryshe nga ajo që është deklaruar

<sup>37</sup> Ministria e Financave

<sup>38</sup> <http://www.al-tax.org/cilesia-e-qeverisjes-dhe-rritja-ekonomike-ne-shqiperi/0>

<sup>39</sup> Mbi Përmirësimin e Mekanizmave të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve midis Biznesit dhe Administratës Publike, Mars 2016

[https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/EN\\_WP-Dispute-Resolution-26-02-2016.pdf](https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/EN_WP-Dispute-Resolution-26-02-2016.pdf)

dhe prezantuar në fillimet e gjykimit të saj. Rritja e kërkesave në biznes dhe ajo e pengesave burokratike kanë sjellë efekt të kundërt dhe në vend që të inkurajojnë qasjen e biznesit, e kanë shtyrë atë drejt informalitetit.

#### **NBF rekomandon:**

- Përzgjedhja e personelit përgjegjës për ankesat administrative (apelimin e taksave) duhet bërë në bazë të kriterëve profesionale;
- Qeveria shqiptare duhet të ngrejë një strukturë organizative të përditësuar duke vendosur përgjegjësi të qarta brenda administratës tatimore dhe një mekanizmi të pavarur apelles.

## **2.4 DIALOGU PUBLIK-PRIVAT**

Ndërtimi dhe implementimi efektiv i dialogut publik-privat është parakusht i padiskutueshëm për promovimin e sektorit privat, gjithashtu për zhvillimin dhe promovimin e një qeverisjeje të hapur. Ky instrument kryen më së miri procesin e informimit të qeverisë lidhur me çështjet e hasura nga sektori privat, e cila mund të adresohet nëpërmjet këtij dialogu në mënyrën më të përshtatshme për të dyja palët, në mënyrë që të përmirësojë klimën e biznesit. Implementimi i një dialogu efektiv publik-privat është i një rëndësie edhe më të madhe për vendet në zhvillim si Shqipëria, me qëllim miratimin e politikave dhe akteve të qëndrueshme dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe ekonomie konkurruese. Në Shqipëri, janë ndërtuar disa platforma si KEK, KI, KT.

### ***Përfaqësja ligjore***

Ligji Nr. 57/2014 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Ekonomik Kombëtar” krijoi KEK, në mënyrë që të sigurojë një bashkëpunim institucional dhe partneritet publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike me synimin për të rritur transparencën në vendimmarrjen publike si dhe përfaqësimin në këtë proces të sektorit privat. Fusha e veprimtarisë së KEK lidhet me nismat nga organet shtetërore për të ndryshuar ligjet dhe aktet nënligjore si dhe për të nxitur ndryshimet politike që rezultojnë të kenë ndikim në sektorë të ndryshëm të ekonomisë si në përgatitjen e paketës fiskale, politikat e zhvillimit të tregtisë, politikat e zhvillimit të biznesit, politikat e mbikëqyrjes së tregut dhe konkurrencës, politikat e punësimit dhe pagave, përmirësimin e legjisllacionit tatimor dhe procedurave përkatëse dhe çështje të tjera të cilat ndikojnë në rritjen ekonomike. KEK kryesohet nga Kryeministri dhe në përbërje të tij ka si pjesëtarë përfaqësues të komunitetit të biznesit, përfaqësues të biznesit të madh (tatimpagues të mëdhenj nga biznesi privat), përfaqësues të Dhomës së Tregtisë dhe Organizatave të Biznesit, si dhe personalitete të ekonomisë kombëtare e botërore. Anëtarësia funksionon me bazë rotacioni në mënyrë që pjesëmarrja në KEK të jetë sa më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Bazuar në Nenin 8 të Ligjit 57/2014, forma të tjera të këshillimit mund të krijohen. Pra, KEK mund të formojë struktura ad-hoc në mënyrë që të fokusohet në çështje, fusha dhe sektorë të caktuar. Ndërkohë, përfshirja e grupeve të interesit (stakeholders) të tjerë, të cilët nuk janë pjesë e KEK, mund të kryhet vetëm nëpërmjet faqes së internetit. Sekretariati Teknik i KEK kryen funksione administrative dhe mbështetëse.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 294, datë 08.04.2015 “Për Krijimin e Këshillit të Investimeve” që ka për qëllim lehtësimin e dialogut mes përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, donatorëve dhe qeverisë në mënyrë që të zhvillojë një klimë biznesi dhe investimesh miqësore, jo diskriminuese dhe paqësore. KI drejtohet nga Ministri i Ekonomisë dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve shqiptare, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësues të biznesit dhe organizatave të biznesit. Qëllimi i KI është promovimi i dialogut konstruktiv ndërmjet sektorit privat dhe qeverisë, për sa i përket zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet identifikimit të pengesave në të bërit biznes dhe

në përthithjen e investimeve duke rekomanduar strategji dhe mekanizma në përmirësimin e situatës si edhe për vlerësimin e projekt – akteve ligjore me ndikim tek biznesi. KI ka për mision të adresojë propozime konkrete pranë Kryeministrit apo Ministrive të linjës për të iniciuar akte normative. Puna e KI asistohet nga Sekretariati Teknik i cili administrohet dhe financohet nga BERZH. Numri i mbledhjeve të Këshillit të Investimeve duhet të jetë të paktën gjashtë takime në vit.

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 665, datë 04.08.2010 “Për përcaktimin e përbërjes dhe mënyrës së funksionimit të Këshillit Tatimor, si dhe të kontributeve financiare të anëtarëve, që përfaqësojnë tatimpaguesit në këtë Këshill” – Këshilli Tatimor synon diskutimin e çështjeve problematike dhe vlerësimin e projekteve, që do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit tatimor me një kosto më të ulët administrative për administratën dhe një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit. Përfaqësimi i sektorit privat në KT është dy fish më i lartë (12 anëtarë) se numri i përfaqësuesve të sektorit publik (6 anëtarë) dhe kjo platformë kryesohet nga dy bashkëkryetarë, përkatësisht zëvendësministri i financave dhe një nga përfaqësuesit e tatimpaguesve.

Pavarësisht se KT drejtohet nga dy bashkëkryetarë, ku njëri përzgjidhet nga komuniteti i biznesit, KEK kryesohet nga Kryeministri (dhe përzgjedh Sekretarin e Përgjithshëm nga komuniteti i biznesit), gjë që mundëson adresimin e problematikave e çështjeve të interesit nga biznesi në nivelin më të lartë. Këshilli i Investimeve drejtohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe ka në përbërjen e vet disa Ministra si anëtarë, që gjithashtu mundëson adresimin e rekomandimeve e problematikave në nivele të larta.

#### Platforma konsultimi të ngritura në baza sektoriale:

- ✓ I parashikuar në Ligjin 93/2015 “Për turizmin”, Komiteti Këshillimor i Sektorit Privat të Turizmit (KKSPT) u mblodh për herë të parë në Prill 2016. KKSPT kryesohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe ka 13 anëtarë me përfaqësi nga dhomat e tregtisë, shoqatat e sipërmarrjeve që operojnë në sektorin e turizmit, organizatat jofitimprurëse dhe donatorë. Qëllimi i këtij Komiteti është bashkëpunimi publik-privat për këshillimin për çështje të rëndësishme në fushën e turizmit dhe zgjidhjen e problematikave që hasen nga operatorët në këtë sektor.
- ✓ Grupi Ndërinstitucional për Koordinimin e Politikës Tregtare dhe Lehtësimin e Tregtisë / Komiteti i Lehtësimit të Tregtisë u ngrit me Urdhër të Kryeministrit Nr. 80, datë 12.05.2016. Ky grup pune funksionon si një organ këshillues e koordinues dhe ka si objektiv përmirësimin e procesit të politikës tregtare dhe lehtësimin e tregtisë, nëpërmjet dialogut mes përfaqësuesve të qeverisë, komunitetit të biznesit në Shqipëri dhe grupeve të tjerë të interesit. Ky grup do të ndërmarrë analiza dhe do të prodhojë rekomandime konkrete për qeverinë në funksion të lehtësimit të tregtisë në mënyrë që ti shërbejnë komunitetit të biznesit.

#### **A. Mungesa e studimeve të mëparshme të vlerësimit dhe të fizibilitetit mbi nevojën për të krijuar platforma dialogu publik-privat**

Gjatë RBF, përfaqësuesit e komunitetit të bizneseve lokale kanë deklaruar se qeveria më pare punonte për të krijuar platforma të reja për zbatimin e dialogut me komunitetin e biznesit por kjo gjë ndodhte me raste. Sipas përfaqësuesve të biznesit që morën pjesë në RBF, qeveria duhet të identifikojë paraprakisht nevojat dhe të vlerësojë objektivisht nëse është i nevojshëm krijimi i një platforme të re në vend që të miratojë krijimin e saj për shkak të interesave të veçanta. Nisur nga zhvillimet në vijim, komuniteti i biznesit shfaq rezervat e veta lidhur me organizimin dhe anëtarësinë e KEK.

Specifikisht, përfaqësuesit e biznesit në KEK duhet të ishin vendosur në konsultim më të ngushtë me biznesin. Bizneset theksojnë se nuk pati ftesa nga KEK për pjesëmarrje të biznesit në këtë platformë. Gjithashtu, rotacioni është bërë pa shumë konsultime dhe marrje mendimi nga konsultimi i biznesit. Sipas forumeve të biznesit, pavarësisht kërkesave dhe letrave të bizneseve të ndryshme për të qenë pjesë e KEK, në përgjithësi ata nuk janë marrë parasysh, as gjatë rotacionit të anëtarëve, që jep mundësinë për adresimin e grupeve të interesit sipas kërkesave.

Të gjitha problemet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me vlerësimin paraprak të nevojës për të krijuar një platformë të caktuar të dialogut publik-privat. Edhe kur vlerësimet paraprake nuk janë kryer sipas raporteve të OECD-së. Është theksuar rëndësia e platformave të konsultimit mes sektorit publik dhe privat. Si rrjedhojë, krijimi i këtyre platformave i shërben dialogut të vazhdueshëm, i cili synon të rrisë transparencën në hartimin e politikave dhe të sigurojë miratimin e politikave miqësore për marrëdhëniet biznes-publik në Shqipëri.

Bazuar në pengesat e mësipërme, **NBF rekomandon:**

- Pasi të jetë krijuar platforma është e rëndësishme përgatitja e një liste të saktë të organizatave dhe shoqatave të biznesit apo dhomave të tregtisë e industrisë, në mënyrë që të ketë një pamje të qartë të përfaqësimit të bizneseve të ndryshme në këto shoqata (sipas sektorëve, madhësisë etj.) dhe të përfaqësimit të tyre në tryezat e konsultimit;
- Bazuar në këtë listë, duhet të ketë një axhendë të qartë me çështje konkrete që kërkojnë diskutim e zgjidhje, e përpiluar bazuar në komentet dhe rekomandimet e komunitetit të biznesit. Kjo listë mund të arrihet si rezultat i disa forumeve e takimeve përgatitore, që ndihmojnë në përzgjedhjen e çështjeve me rëndësi dhe në kuptimin sa më mirë të çështjeve që ngre biznesi;
- Në vijim, një zgjidhje tjetër e mirë do të ishte organizimi i forumeve e tryezave më të vogla konsultative bazuar në çështje specifike të identifikuar sipas axhendës në bashkëpunim me komunitetin e biznesit. Këto tryeza mund të organizohen si takime ad-hoc nën platformat ekzistuese si KEK, KI, KT dhe të adresojnë çështje specifike si dhe të ftojnë përfaqësuesit përkatës të biznesit.

## **B. Mbivendosja e platformave ekzistuese**

Në lidhje me mbivendosje të platformave të konsultimit, ka një debat të vazhdueshëm, veçanërisht mes KEK dhe KI. Për shkak se këto dy platforma veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të shkëputura nga njëra-tjetra, funksionet dhe kompetencat e tyre shpesh mbivendosen. Kjo ndodh sepse të dyja luajnë të njëjtin rol në zhvillimin e një mjedisi të favorshëm biznesi dhe promovimin e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat. Për këtë arsye, kërkohet një koordinim më i mirë dhe një komunikim më efektiv midis vetë platformave të dialogut.

Për të shmangur mbivendosjen e aktiviteteve të platformave të dialogut dhe konsultimit, **NBF rekomandon:**

- Krijimi i një dialogu të mirë mes qeverisë dhe biznesit lehtësohet edhe më tej kur ka dialog mes vetë Këshilleve. Kjo mund të arrihet përmes masave dhe sugjerimeve të mëposhtme:
  - a. Sekretariatet teknike duhet të shkëmbejnë informacion paraprak në lidhje me axhendën e temave të dialogut,

*b. Duhet të shkëmbejnë informacionin e dhënë kur një biznes i drejton një çështje të caktuar njërës prej platformave,*

*c. Sekretariatet duhet të mbajnë forume të përbashkëta ad-hoc, sidomos kur të njëjtat çështje janë paraqitur nga bizneset në të dyja platformat,*

*d. Sekretariatet duhet të kryejnë studime dhe analiza të përbashkëta,*

*e. Sekretariatet duhet të udhëheqin bizneset drejt platformës së duhur kur çështja që i adresohet nuk i përket fushës së aktiviteteve të KEK ose KI.*

- Të informohet komuniteti i biznesit sa më shumë që të jetë e mundur për të kuptuar qëllimin e çdo platforme dhe se si secila prej tyre mund të mbështesë biznesin;
- Rritja e përfaqësisë së biznesit në këto platforma duke ftuar një numër më të madh.

### **C. Mungesa e rezultateve efektive**

Siç është përcaktuar me ligjet përkatëse të themelimit të platformave, rezultatet e pritshme nga ato ishin: Analiza e praktikave arbitrare dhe shqetësimet e identifikuara nga organizatat e biznesit dhe disa rekomandime për zgjidhjen e këtyre çështjeve; në vijim të rekomandimeve, komenteve, vërejtjeve, etj, mbledhur nga mbledhjet e NEC, IC dhe TC, dhe përfshirjen e tyre (të atyre që mund të përfshihen pas analizave përkatëse) në politikë, në hartimin e legjislacionit, etj.; diskutimi i temave të propozuara nga ana e biznesit në disa takime zyrtare; diskutimi i temave në takimet ad-hoc edhe në qoftë se nuk janë të parashikuara në rendin e ditës; përgatitjen e raporteve, anketimeve dhe studimeve mbi çështjet që lidhen me objektivin e Këshilleve; në konsultim paraprak me komunitetin e biznesit (jo pas hartimit të një projekt-ligji, duke qenë në një fazë të avancuar).

Ndër arsyet kryesore të mungesës së efikasitetit, ngelet mungesa e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin e biznesit, e cila krijoi një boshllëk në analizën e problemeve të vërteta. Vlen të përmendet fakti se ligjet tatimore kanë ndryshuar shpesh, edhe pas krijimit të këtyre platformave që kanë të bëjnë me dialogun publik-privat. Është e qartë se ato nuk kanë arritur as të krijojnë një situatë të qëndrueshme ligjore. Vetëm ligji për procedurën tatimore ka ndryshuar dy herë në vitin 2015 dhe përsëri në 2016. Ndryshimet e miratuara në vitin 2015 u sfiduan në Gjykatën Kushtetuese, vendimi i secilës për të shfuqizuar këto ndryshime solli nevojën për ndryshime të tjera të miratuara gjatë vitit 2016. "Shoqata për Mbrojtjen e Tregtisë dhe Tregtarëve" kërkoi që të anulohen këto ndryshime pasi janë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Nga përmbajtja e ligjit për procedurat tatimore është vërejtur se ndryshimet dhe plotësimet e bëra në ligjin për procedurat tatimore adresojnë çështje që kanë të bëjnë me riorganizimin e administratës tatimore dhe luftën kundër konfliktit të interesave, si dhe të përcaktojnë dënime të rrepta për ata që veprojnë në kundërshtim me ligjin ose nuk vepron ndaj taksapaguesve të cilët synojnë të ushtrojnë kontrabandë dhe evazion fiskal. Ndryshimet e miratuara në ligjin e procedurave tatimore nuk respektojnë parimin e proporcionalitetit sipas nenit 17 të Kushtetutës, çenojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën e pronës në referim të neneve 11 dhe 41 të Kushtetutës, u vendos shfuqizimi i tyre. Normat e reja të miratuara në 2015 nuk siguronin një marrëdhënie të arsyeshme proporcionale ndërmjet masës së përdorur dhe qëllimit që kërkohet të arrihej dhe për rrjedhojë mbi bizneset rëndojnë një barrë e paarsyeshme. Masat e reja të gjobës për tatimpaguesit çënonin edhe të drejtën e pronës pasi në thelb çonin në pakësim të pasurisë dhe masa kaq të konsiderueshme nuk bazoheshin mbi asnjë interes të përligjur.

Gjykata pranoi gjithashtu argumentin që formulimi i dispozitave të kundërshtuara nuk plotësonte kërkesat për siguri dhe qartësi duke cënuar parimin e sigurisë juridike. Përveç këtyre, masat e reja çënonin edhe parimin e barazisë sipas nenit 18 të Kushtetutës duke qenë se parashikonin trajtim të

diferencuar mes tatimpaguesve të mëdhenj dhe atyre të vegjël për të njëjtën shkelje, diferencim që nuk përlligjet nga arsye të interesit publik.

Realizimi me sukses i të drejtës së tregtarëve/tatimpaguesve për të sfiduar në nivelin e Gjykatës Kushtetuese aktin ligjor që cënonte interesat e ligjshëm të tyre dëshmon për faktin se dialogu publik-privat nuk ka funksionuar në mënyrë efektive dhe të gjitha strukturat përkatëse përfshirë KEK, KI, KT nuk kanë përmbushur me sukses mandatin për të cilin janë krijuar edhe pse e kishin në objektin e veprimtarisë së tyre këtë ligj. Nga ana tjetër realizimi me sukses i kësaj të drejte nga ana e bizneseve, dëshmon se bizneset janë në gjëndje të organizohen për të prodhuar rekomandime e opinione të vlefshme si nga pikëpamja ligjore ashtu edhe nga pikëpamja e përmirësimit të pozitës së tyre në të bërit biznes.

Edhe pse këto platforma kanë një bazë ligjore të rregulluar dhe të miratuar nga ekspertë të huaj, sipas komunitetit të biznesit, nuk janë arritur rezultatet e pritura.

#### **NBF rekomandon:**

- Rritja e kapacitetit të sekretariateve teknike (kur stafi është i pamjaftueshëm), në mënyrë që të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të kryer hulumtime, analiza, raporte, përmbledhje të rekomandimeve, vëzhgime, etj, të biznesit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre;
- Bashkëpunim të ngushtë të sekretariateve teknike me përfaqësues të biznesit në mënyrë që të hartojnë axhendat vjetore dhe të zgjedhin temat e takimeve, etj;
- Bashkëpunim mes institucioneve shtetërore (nëpërmjet sekretariateve teknike) dhe organizatave të biznesit në lidhje me përgatitjen e sondazheve dhe studimeve apo projekteve të ndryshme.

#### **D. Mungesa e kanaleve të komunikimit në nivel lokal**

Ka dy çështje kryesore që duhen trajtuar lidhur me kanalet e komunikimit me nivelin lokal: Së pari mungesa e komunikimit efektiv mes komunitetit të biznesit dhe qeverisjes lokale, siç është deklaruar edhe në Forumet Rajonale të Biznesit. Autoritetet publike shpesh herë dështojnë në informimin e grupeve të interesit lokal në lidhje me nisjen e marrjes së një vendimi. Kjo kufizon pjesëmarrjen aktive të komunitetit të biznesit në hartimin e draft-vendimeve si dhe mundësinë për të ofruar perspektivat e tij për të kapërcyer shqetësimet me të cilat përballlet në praktikë. Së dyti përfaqësimi i grupeve të interesit lokal në platformat ekzistuese konsultuese në nivel kombëtar. As KEK as KT nuk kanë asnjë përfaqësim lokal që të jetë zëri i tyre në bord. Ndryshe prej tyre, KI që ka në bordin e tij Ministrin e Pushtetit Lokal.

#### **NBF rekomandon:**

- Autoritet lokale duhet të japin shembuj pozitiv të konsultimeve që ndodhin në nivel ndërkombëtar dhe të japin ide e më pas të krijojnë platforma konkrete për të kryer konsultime në nivel lokal. Një mundësi është që ata të kërkojnë asistencë teknike nga homologët e tyre të huaj për kryerjen e konsultimeve dhe për të qenë sa më transparent me komunitetin lokal;
- Autoritetet lokale duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në platformat ekzistuese në nivel kombëtar.

## **E. Mungesa e transparencës në platformat ekzistuese**

Në platformat ekzistuese shqiptare, mungesa e komunikimit efektiv dhe mungesa e të dhënave të rifreskuara, pengon realizimin e një dialogu efektiv. Por sekretariati i KEK ka ndërtuar dhe menaxhon faqen web të KEK ku anëtarët mund të japin ide, feedback, propozime dhe rekomandime. Megjithëse angazhimi i palëve të interesit realizohet nëpërmjet ndërveprimit në faqen web të KEK, nga një vizitë në këtë faqe shihet qartë se informacioni që ndodhet aty është i cekët, i pjesshëm dhe i pa-azhurnuar. Palët e interesit duke përfshirë edhe shoqatat e biznesit duhet të njoftohen rreth shqyrtimeve të KEK dhe ministritë përkatëse nuk i publikojnë në faqen e tyre të internetit e as nuk i shpërndajnë në mënyra të tjera rezymetë apo përmbledhjet e rekomandimeve të marra nga komuniteti i biznesit. Kjo është arsyeja pse është e pamundur për të gjetur se cilat rekomandime janë pranuar dhe cilat janë hedhur poshtë, së bashku me arsyen e refuzimit të tyre. Rekomandimet e marra gjatë konsultimeve publike nuk janë botuar në ndonjë nga faqet e internetit të Ministrive apo në platformat publike. Në këtë drejtim, KI ka bërë disa hapa pozitive. Website i saj është më i përditësuar në krahasim me platformat e tjera.

Sipas RBF-ve, qeveria duhet të kërkojë mendimin dhe kontributin e komunitetit të biznesit paraprakisht, përpara se të hartohet një projekt-ligj apo të ndërmerret një reformë. Kjo do të kontribuonte në një dialog efektiv e më transparent me komunitetin e biznesit. Një sfidë tjetër mbetet vëmendja ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Përfaqësia e tyre mund të mos jetë e madhe nisur nga anëtarët, kjo vërehet në Këshillet ekzistuese. Duke qenë se SME-të nuk janë aq të mirë-organizuara; nevojat e tyre janë shumë diverse dhe mund të mos konsiderohen plotësisht në zhvillimin e politikave dhe hartimin e legjislativioneve.

### **NBF rekomandon:**

- Këto platforma dhe ministritë përkatëse duhet të publikojnë dokumentet që shoqërojnë aktet normative gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe adaptimit (Tabela e divergjencave, rekomandimet dhe opinionet në çdo fazë të procesit të vendim-marrjes dhe termat e botimit);
- Duhet që të publikohen të gjitha rekomandimet e marra nga komuniteti i biznesit dhe pozicionin e institucioneve publike, pranimin apo refuzimin e tyre shoqëruar me argumentat përkatëse;
- Duhet të ketë më shumë mundësi për përfshirjen e SME-ve në informimin dhe vendimmarrjen në çështjet ekonomike.

## **F. Mungesa e kapaciteteve teknike të sekretariateve përfaqësuese të platformave ekzistuese**

Sekretariatet teknike të platformave ekzistuese të dialogut publik-privat luajnë një rol të rëndësishëm në procesin konsultues sepse ata merren me monitorimin e progresit të takimit dhe me rekomandimet e adresuara nga takimet, prandaj ata duhet të ndjekin edhe mundësinë e zbatimit ose jo të këtyre rekomandimeve dhe mundësinë që ato kanë për t'u përfshirë në draftet e hartuara nga politik-bërësit. Vlen të përmendet se KI ka bërë një punë të mirë për sa i përket dokumenteve teknike mbi të dhënat e komunitetit të biznesit dhe procesit të advokimit. Këshilli Ekonomik Kombëtar përbëhet nga një sekretariat teknik i vogël në numër (1 person), dhe si rezultat, shfaqet si problem në rrjedhën e punës së tyre.



## **NBF rekomandon:**

- Është e rëndësishme të ketë një staf më të madh në numër dhe një ndarje të qartë të detyrave, të tilla si: koordinimi online i konsultimeve, monitorimi i kërkesave dhe rekomandimeve që rrjedhin nga mbledhjet e KEK dhe nga të gjitha forumet online, organizimi i takimeve të KEK, organizimi i analizave, etj. Gjithashtu, stafi mund të rekrutohet duke marrë në konsideratë të gjitha aftësitë teknike; në këtë mënyrë disa nga anëtarët e sekretariatit teknik do të kenë njohuri nga fusha specifike që janë diskutuar në tryezat e forumeve konsultive.
- KEK të ngrejë një zyrë ankesash në mënyrë që ti delegojë asaj përgjegjësinë e sekretariatit teknik ndaj ankesave; kështu secili mund të kryejnë në mënyrë efikase detyrat e saj përkatëse në lidhje me komunitetin e biznesit.

## **G. Mungesa e implementimit efektiv të ligjit**

Ligji i ri shqiptar ka adresuar nevojën për një kanal komunikimi të garantuar ndërmjet sektorit privat dhe atij publik. Ndërsa është themeluar, pjesëmarrësit e RBF mendojnë se kuadri ligjor dhe strukturat janë të papërshtatshme dhe nuk çojnë në transparencë dhe konsultim. Nëse jepen njoftime, zakonisht kjo ndodh në fund të procesit të hartimit të një ligji ku dhënia e inputeve bëhet e pamundur.

Çdo institucion duhet të ketë një pikë qendrore ose një departament përkatës që monitoron punën e Këshillit. Duhet të përfshijë, por nuk duhet të kufizohet vetëm në pikat në vijim, në mënyrë që publiku i gjerë të informohet:

- Koordinim me Sekretariatit Teknik;
- Raporton kur janë ndërmarrë iniciativat dhe reforma legislative;
- Raporton kur kërkohet një konsultim;
- Informon për aktivitete të ndryshme të organizuara nga institucioni në konsultim me sektorin privat;
- Dërgon materialet e nevojshme për publikim në faqet e internetit të Këshillit.

Aktualisht, barra e zbatimit të ligjit qëndron tek Sekretariati Teknik dhe, nëse mbivlerësohet ose mungon shkathtësia e duhur, siç shihet me NEC në seksionin e mëparshëm, shanset për të qenë në përputhje me ligjin janë të ulëta.

### ***Përfaqja ligjore***

Ligji Nr. 146/2014 “ Mbi njoftimin dhe konsultimin publik” është aprovuar në vitin 2014 me qëllim që të rregullojë procesin e njoftimit dhe konsultimit publik të draft dokumenteve që kanë një interes të lartë publik, si draft ligjet, aktet normative, projektet strategjike dhe aktet e veprimit.

Qëllimi i këtij ligji është promovimi i transparencës së autoriteteve publike dhe rritja e përgjegjësisë së tyre. Ky ligj e ka të specifikuar procedurën që duhet ndjekur që të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes, të ndërmarra nga autoritetet publike përmes raporteve paraprake, njoftimet dhe mbledhjet publike, me qëllim që të marrin mendimet dhe sugjerimet e palëve të interesit rreth përmbajtjes dhe përmirësimit të draft akteve në fjalë. Palët e interesit, duke përfshirë këtu autoritetet publike, grupet e interesit dhe individët e huaj ose shqiptar kanë të drejtën të marrin pjesë në mënyrë aktive madje edhe proaktive, njëkohësisht duke propozuar adoptimin e aktit specifik.

Ligji Nr. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit” ka si qëllim promovimin e integritetit, transparencës dhe përgjegjësisë të autoriteteve publike duke garantuar të drejtën e publikut për tu njohur me informacionin që kanë autoritetet publike.

Ligji Nr. 119/2015 “Mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” ka si qëllim të garantojë bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në favor të mirëqeverisjes dhe transparencës në publik të vendimmarrjes përmes Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (*KKSHC*). Në këtë këshill marrin pjesë përfaqësues të zyrës së Kryeministrit, ministrisë dhe katër përfaqësues të shoqërisë civile nga sektorë të ndryshëm, përfshirë këtu sektorin e ekonomisë, atë territorial dhe zhvillimit të mjedisit.

Për të zgjidhur këto shqetësime, **NBF rekomandon:**

- Sekretariatet teknike të KI duhet të lejojnë një funksionim më të mirë të informimit paraprak të bizneseve. Ndërveprimet e vazhdueshme midis përfaqësuesve të biznesit dhe sekretariateve teknike mund të ndihmojnë më shumë në zbatimin rigoroz të ligjit dhe ushtrimin e presionit të duhur për implementimin;
- Një koordinim më i mirë mes agjencive qeveritare, ministrive përkatëse dhe agjencive me institucionet e qeverisë lokale dhe sekretariatet teknike.

### 3. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nr.	Situata aktuale/ekzistuese	Ndryshimet e propozuara	Drejtuar
<b>KONTROLLI TATIMOR</b>			
<b>A. Mosfunksionimi i plotë i sistemit të përzgjedhjes në bazë të riskut</b>			
<b>Sistemi i përzgjedhjes bazuar në vlerësimin e analizës së riskut, mbetet akoma në fazë zhvillimi, duke mos dhënë rezultatet e pritshme</b>	Përzgjedhja e taksapaguesve nuk është rezultat i vlerësimit të analizës së riskut dhe kjo e fundit nuk është implementuar në të gjithë vendin.	NBF rekomandon DPT që kontrolli tatimor të jetë i bazuar vetëm në analizën e vlerësimit të riskut dhe kjo duhet të zbatohet në të gjitha qarqet e Shqipërisë.	DPT
<b>Sistemi i vlerësimit bazuar në analizën e riskut, akoma nuk po gjen aplikimin në përputhje me detyrimin ligjor</b>	Në bazë të ligjit për procedurat tatimore, kontrollet e kryera nga administrata tatimore në rastin kur një biznes kërkon të mbyllë aktivitetin e tij, duhet të jenë subjekt i përzgjedhjes bazuar në analizën e riskut (parim i përgjithshëm) por kjo nuk po ndodh.	NBF rekomandon DPT që kontrollet specifike lidhur me procedurat e mbylljes të bazohen tërësisht në analizën e riskut.	DPT
<b>NBF rekomandon:</b>			
<b>Sistemi i vlerësimit bazuar në analizën e riskut, akoma nuk po i shërben përpjekjeve dypalëshe administratë – biznes, për minimizimin e informalitetit në vend</b>	Taksapaguesit që janë nën pragun 8 milionë e sidomos ato nën 5 milionë lekë, janë të pa interesuar të formalizojnë biznesin e tyre. Për atë kohë që pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara i përkasin kësaj kategorie, kontrollet tatimore bëhen për këtë grup. Niveli i lartë i kontrolleve nuk inkurajon reduktimin e informalitetit.	Ngritjen e një strukture efikase të analizës së riskut, organizative në qendër, pra në drejtorinë qendrore të tatimeve (DPT), me specialiste me eksperience e të përgatitur teorikisht;	DPT
		Zbatimin e një projekt-pilot për përzgjedhjen e plotë të tatimpaguesve për kontroll mbi bazën e analizës së riskut të paktën në tre drejtori rajonale tatimore, gjate 6-mujorit të dytë të 2017;	DPT&DRT
		Me qëllim shkurtimin e ndjeshëm të afatit të çregjistrimit përfundimtar të bizneseve, kontrollet specifike që lidhen me procedurën e mbylljes, të bazohen tërësisht në analizën e riskut.	DRT
		Administrata tatimore të shprehet publikisht për afatin kur do të bëjë të mundur implementimin e plotë të sistemit të analizës së riskut, në të gjithë drejtorinë rajonale të	DPT

		tatimeve.	
		<b>NBF rekomandon:</b>	
<b>B. Mos zbatimi i të drejtës së informimit dhe njoftimit nga administrata tatimore</b>	Në takimet rajonale konstatohet se ka një mosnjohim paraprak para një kontrolli. Për më tepër bizneset nuk janë informuar mbi të rejat më të fundit të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në aktivitetin e tyre ditor.	Shtirjen e rrjetit të shërbimit të tatimpaguesve në disa qendra (jo vetëm në një për çdo qytet), për të qenë shumë më pranë përdoruesve të sistemit;	DPT
		Ngritjen e një sistemi informimi të vazhdueshëm, në të gjithë sportelet e QKB-së, aty ku bëhet regjistrimi fillestar i çdo biznesi;	QKB
		Organizimin e tryezave publike informuese me grup-biznese për të përditësuar periodikisht ndryshime të akteve ligjore e nënligjore, çdo përmirësim të procedurave tatimore;	DPT
		DPT, të publikojë vendimet teknike dhe ligjet e reja ose të përmirësuara në faqen e saj, që komuniteti i biznesit të marrë informacion.	DPT
		<b>NBF rekomandon:</b>	
<b>C. Moszbatueshmëria e së drejtës për kontrollin të arsyeshme</b>	Lidhur me moszbatueshmërinë e përzgjedhjes tatimpaguesit të cilët do të jenë subjekt i kontrollit tatimor dhe duke marrë parasysh deklaratat anëtarëve të NBF, ka mungesë të zbatimit të së drejtës së tatimpaguesit për kontrollin të arsyeshme dhe kjo është pranuar gjatë RBF.	Hartimi sa më shpejt të jetë e mundur i akteve nënligjore nga Ministria e Financave dhe gjithashtu rregullave përkatëse teknike, lidhur me zbatimin e procedurave të reja të kontrollit tatimor;	Ministria e Financave
		Hartimi i një manuali të ri të kontrollit tatimor dhe publikimit në faqen zyrtare të administratës tatimore.	DPT
		<b>NBF rekomandon:</b>	
<b>D. Dënime administrative të pamotivuara</b>	Në diskutimet e RBF, u evidentua problemi i vendosjes së dënimeve administrative në mospërputhje me ligjin. Shumica e ndëshkimeve janë vendosur pas përfundimit të kontrollit, pa një diskutim paraprak me përfaqësues të biznesit dhe në mospërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.	Departamentet përgjegjëse në DPT për ofrimin e shërbimeve dhe edukimin e tatimpaguesve, të ushtrjnë saktë detyrimin e tyre për të informuar, edukuar dhe për të ndihmuar bizneset, në mënyrë që ata mund t'u përmbahen detyrimeve të tyre të ligjore;	DPT
		Departamenti i Kontrollit Tatimor në DPT duhet t'u japë bizneseve mundësinë për të diskutuar dhe për të mbrojtur veten e tyre në përputhje me ligjin, gjatë kontrollit dhe në fund të tij;	DPT

		Departamenti i Kontrollit Tatimor dhe Departamenti i Apelit duhet të kujdeset për çdo akt konstatimi, çdo raport kontrolli në mënyrë që të jenë në përputhje me ligjin dhe të citojë në mënyrë të drejtë bazën ligjore të cilës i referohet, përndryshe ajo duhet të konsiderohet si një akt i pavlefshëm administrativ nga administrata tatimore.	DPT
<b>E. Sistemi i prezantuar në vitin 2015 krijoi disa probleme</b>	Një shqetësim me të cilin komuniteti i biznesit po përballlet prej dy vjetësh, sipas anëtarëve pjesëmarrës në takimet e zhvilluara në RBF, ka të bëjë me implementimin e sistemit të ri elektronik të tatimeve	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Administrata tatimore duhet të marrë përgjegjësitë që i takojnë, diktuar nga roli i saj në marrëdhëniet e partneritetit me biznesin;	DPT
		Administrata tatimore duhet të plotësojë detyrimin e saj për të mundësuar informimin e përhershëm të tatimpaguesve;	DPT
		Administrata tatimore duhet të rrisë përpjekjet për të lehtësuar përdorimin e sistemit elektronik të tatimeve.	DPT
<b>F. Niveli etik dhe profesional i inspektorëve tatimorë</b>	Nga një pjesë e administratës, përfshirë sidomos atë tatimore, reflekton fenomene negative si paaftësia profesionale, mungesa e etikës, mungesa e transparencës. Inspektorët tatimorë nuk janë gjithmonë efektive në komunikimin e tyre me tatimpaguesit, duke çuar kështu në situata të paqarta gjatë një kontrolli tatimor. Përveç kësaj, ata nganjëherë nuk bashkëpunojnë me tatimpaguesit gjatë procesit të kontrollit tatimor.	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Rekrutimi i punonjësve të administratës tatimore në veçanti, të kryhet sipas disa rregullave strikte të lidhura me përzgjedhjen e tyre;	DPT
		Trajnimi për kandidatët e përzgjedhur të jetë gjithashtu si kusht, përpara se ato të fillojnë punën në administratë. Njëkohësisht trajnime periodike, të paktën 4 herë në vit, ku mund të ketë bashkëpunim dhe përfshirje edhe të specialistëve, ekspertëve, këshilltarëve të biznesit, të bëhen traditë;	DPT
		Procesi i vlerësimit të performancës duhet të kryhet rregullisht, bazuar në direktivat e ligjit për Administratën Publike;	DPT
		Kontrolli praktik në vijimësi, gjatë gjithë vitit, nga strukturat e specializuara si të kontrollit tatimor, audituese dhe ato antikorrupsion, duhet të jetë efektiv dhe raportues për publikun çdo vit kalendarik;	DPT
		Zbatimi i plotë i efektiv i linjës telefonike në Drejtoritë Tatimore, në lidhje me denoncimet	DPT

		e tatimpaguesve;	
		DPT të publikojë raportet vjetore lidhur me indikatorët kundër korrupsionit..	DPT
<b>SEKTORIALIZIMI I TVSH</b>			
<b>A. TVSH në sektorin e përpunimit aktiv (Industria Fasonit)</b>	Derisa u prezantua dhe filloi zbatimi i ligjit të ri për TVSH-në më 1 janar të vitit 2015, i cili përcakton se:	Në bazë të analizës së mësipërme dhe shqetësimeve të industrisë fason, anëtarët e NBF rekomandojnë për shërbimet e ofruara nga nën-kontraktorët për kontraktorët e regjimit të përpunimit aktiv, tatim me normë TVSH-je prej 0%. Direktiva 2006/112 CE BE-së përjashton nga TVSH-ja mallrat e shitura nën regjimin e përpunimit aktiv. Kjo është përfshirë edhe në legjislacionin shqiptar, por vetëm për kontraktorët kryesore, me përjashtim nën-kontraktorët e tyre.	Ministria e Financave
	a) <b>norma e TVSH-së 0%</b> për përpunimin e mallrave jo-shqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv duhet të zbatohet në faturën e lëshuar nga operatori eksportues, e cila është e bashkangjitur për të ri-eksport deklaratës doganore e këtyre mallrave		
	b) Në rast se kryerja e shërbimit për përpunimin e mallrave jo-shqiptare të destinuar për ri-eksport, kryhet nga një nën-kontraktor i cili kryen këtë shërbim në emër të kompanisë e përpunimit aktiv (kompani eksportuese), ky shërbim është i tatueshëm me <b>normë TVSH prej 20%</b> .		
<b>B. TVSH në sektorin bujqësor</b>	TVSH në sektorin bujqësor është aktualisht 20 %.	Bazuar në analizën e mësipërme, anëtarët e Forumit Kombëtar të Biznesit rekomandojnë Ministrisë së Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrë në konsideratë zbatimin e reduktimit të TVSH-së për sektorin e bujqësisë nga 20% në 10%.	Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë
<b>C. TVSH në sektorin e Turizmit</b>	<b>TVSH-ja prej 20%</b> e aplikuar në sektorin e turizmit përfaqëson pjesën më të madhe të barrës fiskale, në krahasim me llojet e tjera të tatimeve dhe kjo TVSH ka një <b>ndikim të drejtpërdrejtë mbi çmimet</b> në këtë sektor.	NBF rekomandon Ministrisë së Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Turizmit, të reduktojë TVSH-në nga 20% në 10%. Ky propozim është në përputhje me dispozitat e Direktivës së Këshillit Evropian 2006/112 i datës 28 nëntor 2006, "Për sistemin e përbashkët të TVSH-së", dhe me atë të Direktivës së KE 2009/47 /.	Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Turizmit
<b>INFORMALITETI</b>			

<b>A. Aksionet jo efektive të qeverisë kundër informalitetit</b>	Aksioni kundër informalitetit dhe ndëshkimet jo proporcionale të vendosura mbi sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), rriti frikën e komunitetit të biznesit nga pikëpamja psikologjike. Aksioni kundër informalitetit nuk u aplikua njësoj për të gjithë komunitetin e biznesit	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Ministria e Financave të publikojë dhe të konsultojë strategjinë paraprake në lidhje me reduktimin e informalitetit.	Ministrisë së Financave
		DPT duhet që të realizojë kontrollet tatimore tek të gjithë bizneset pa dallim nga madhësia e tyre duke u bazuar në analizën e vlerësimit të riskut	DPT në bashkëpunim me Ministrinë e Financës
		Ndërmarrja e fushatave sensibilizuese për të ndihmuar bizneset në procesin e gjatë të formalizimit;	DPT
		Në lidhje me informalitetin në turizëm, NBF rekomandon që kjo problematikë të menaxhohet nga qeveria lokale. Kjo e fundit duhet të identifikojë çdo apartament/ndërtesë që shërben për qëllime ekonomike dhe të regjistrojë të gjitha ato që përdoren për shërbime hotelerie duke vendosur një shenjë të dukshme në godinën e tyre në mënyrë që të jenë transparente dhe të tregojnë se këto ndërtesa janë të regjistruara dhe në përputhje me legjislacionin përkatës	Qeverisë Lokale
<b>B. Ndarja e tatimit mbi fitimin në sistemin tatimor</b>	Bizneset po përpiqen që të qëndrojnë në nivelin zero të tatimit, duke qëndruar nën fashën e xhiros vjetore prej 5 milion Lek.	Administrata tatimore të vendosë tek bizneset me xhiro nga 2 deri në 8 milion Lek vetëm një taksë të thjeshtëzuar fitimi prej 5%.	DPT
<b>C. Ndarja e TVSH-së në Shqipëri</b>	Pragu i lartë nxit bizneset që janë subjekt i TVSH të shndërrohen në informal. Bizneset e regjistruar si taksapagues të tatimit të thjeshtëzuar mbi fitimin (0%), kundrejt bizneseve të mëdha të cilat paguajnë tatim mbi fitimin (15%) nuk janë të interesuara për të marrë një faturë tatimore për çdo transaksion dhe në këtë mënyrë ndërmarrin veprime jo formale me ndërgjegje të plotë	Pragu i TVSH-së, nga 5 milion ALL duhet të jetë 2 milion ALL. Në të njëjtën kohë, organet financiare duhet të marrin në konsideratë llojet speciale të aktiviteteve ekonomike si punët artizanale apo të llojeve të ngjashme, të cilat pavarësisht nivelit të xhiros marrin materialin bruto nga natyra pa pasur mundësinë për të kredituar TVSH-në për blerjet e mundshme.	DPT
<b>D. Detyrime të larta të shoqëruara me kosto të fshehura</b>	Gjatë FRB-ve, përfaqësuesit e biznesit pruan se në lidhje me taksat e larta ka gjithashtu dhe kosto administrative të cilat	<b>NBF rekomandon:</b>	

	krijohen si rezultat i nivelit të lartë të burokracisë apo të disa tarifave të tjera për shërbime të ndryshme të kryera nga institucionet publike. Këto tarifa nuk janë pjesë e ligjit por përbërja e tyre po dëmton buxhetin shtetëror.	Rishikimin e normës së tatimit dhe kthimin në nivelin e mëparshëm prej 10%, i krahasueshëm me vendet fqinje;	Ministria e Financës
		Rishikimin e nivelit të taksës që ndikon mbi infrastrukturën e cila bie në kundërshtim me parimet e taksimit duke qenë se aplikohet mbi çmimin e shitjes në të njëjtën mënyrë si një taksë mbi konsumin (si një TVSH e dytë e fshehur, por në normën 8%).	Ministria e Financës
<b>E. Paqëndrueshmëria dhe cilësia e legjislacionit</b>	Gjatë RBF, paqëndrueshmëria e legjislacionit u diskutua si një faktor i cili pengon përputhshmërinë totale me detyrimet ligjore.	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Duhet ti lihet më shumë kohë komunitetit të biznesit kur bëhet fjalë për hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve;	Ministria e Financës & Ministra e Ekonomisë & Qeveria
		Ligjvënësit duhet të krijojnë më shumë hapësirë për debat dhe të promovojnë diskutimet në tavolina të rrumbullakëta me pjesëmarrjen e anëtarëve të parlamentit dhe ekspertëve;	Ministria e Financës & Ministra e Ekonomisë & Qeveria
		Do të ishte pozitive rritja e qëndrueshmërisë së legjislacionit duke bërë ndryshime aty ku është e nevojshme.	Ministria e Financës & Ministra e Ekonomisë & Qeveria
<b>F. Mungesa e shërbimeve publike për taksat që paguhen</b>	Mungesa dhe cilësia e ulët e shërbimeve publike dekurajon pagesën e taksave nga ana e bizneseve dhe inkurajon informalitetin.	<b>NBF rekomandon:</b>	
			Qeveria
		Krijimi i një sistemi të vazhdueshëm ose periodik të sistemit të monitorimit në lidhje me përdorimin e fondeve publike nga qeveria;	Qeveria
		Organizimi i sondazheve me grupe të ndryshme të interesit për rezultatet e arritura dhe ato të pritshme në lidhje me përdorimin e fondeve publike.	Qeveria
<b>G. Besimi i ulët i komunitetit të biznesit ndaj</b>	Gjatë RBF, pjesëmarrësit e konsideronin	<b>NBF rekomandon:</b>	



institucioneve apeluese	korrupsionin si një çështje që duhet të merret menjëherë parasysh për aq kohë sa anëtarët e tyre përballen me inspektorë të tatimeve dhe doganave apo inspektorë të tjerë të cilët kërkojnë vazhdimisht ryshfet. E njëjta gjë ndodhi edhe me përfaqësuesit e sistemit gjyqësor.	Përzgjedhja e personelit përgjegjës për ankesat administrative (apelimin e taksave) duhet bërë në bazë të kriterëve profesionale;	DPT
		Qeveria shqiptare duhet të ngrëjë një strukturë organizative të përditësuar duke vendosur përgjegjësi të qarta brenda administratës tatimore dhe një mekanizmi të pavarur apelues.	Qeveria
<b>DIALOGU PUBLIK PRIVAT</b>			
<b>A. Mungesa e studimeve të mëparshme të vlerësimit dhe të fizibilitetit mbi nevojën për të krijuar platforma dialogu publik-privat; përzgjedhja e pjesëmarrësve në platformat publike-private</b>	Qeveria dhe krijuesit e platformave nuk identifikojnë objektivist nevojat e komunitetit të biznesit kur i krijojnë ato.	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Pasi të jetë krijuar platforma është e rëndësishme përgatitja e një liste të saktë të organizatave dhe shoqatave të biznesit apo dhomave të tregtisë e industrisë, në mënyrë që të ketë një pamje të qartë të përfaqësimit të bizneseve të ndryshme në këto shoqata (sipas sektorëve, madhësisë etj.) dhe të përfaqësimit të tyre në tryezat e konsultimit;	Të gjitha platformat
		Bazuar në këtë listë, duhet të ketë një axhendë të qartë me çështje konkrete që kërkojnë diskutim e zgjidhje;	Të gjitha platformat
		Organizimi i forumeve e tryezave më të vogla konsultative bazuar në çështje specifike të identifikuar sipas axhendës në bashkëpunim me komunitetin e biznesit.	Të gjitha platformat
<b>B. Mbivendosja e platformave ekzistuese</b>	Platformat ekzistuese mbivendosen në fushëveprimin, misionin dhe aktivitetet e tyre.	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Rritja e bashkëpunimit dhe komunikimit midis platformave ekzistuese;	Të gjitha platformat
		Të informohet komuniteti i biznesit sa më shumë që të jetë e mundur për të kuptuar qëllimin e çdo platformë dhe se si secila prej tyre mund të mbështesë biznesin	Të gjitha platformat
		Rritja përfaqësive së biznesit në këto platforma duke ftuar një numër më të madh.	Të gjitha platformat
<b>C. Mungesa e rezultateve efektive</b>		<b>NBF rekomandon:</b>	

	Mungesa e rezultateve të pritura dhe efektive nga platformat ekzistuese ishte një shqetësim kyç. KEK, KT deri tani nuk kanë dhënë rezultate pozitive për shkak të disa arsyeve, duke filluar nga mungesa e kapaciteteve profesionale e deri tek mungesa e dëshirës për komunikim të ngushtë me komunitetin e biznesit.	Rritja e kapacitetit të sekretariateve teknike (kur stafi është i pamjaftueshëm), në mënyrë që të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të kryer hulumtime, analiza, raporte, përmbledhje të rekomandimeve, vëzhgime, etj., të biznesit dhe për të monitoruar zbatimin e tyre;	KK, KT
		Bashkëpunim të ngushtë të sekretariateve teknike me përfaqësues të biznesit në mënyrë që të hartojnë axhendat vjetore dhe të zgjedhin temat e takimeve, etj.	Sekretariatet e platformave
		Bashkëpunim mes institucioneve shtetërore (nëpërmjet sekretariateve teknike) dhe organizatave e biznesit në lidhje me përgatitjen e sondazheve dhe studimeve apo projekteve të ndryshme.	Të gjitha Ministrinë e Linjës që lidhen me komunitetin e biznesit
<b>D. Mungesa e kanaleve të komunikimit në nivel lokal</b>	Ekziston një mungesë e komunikimit efektiv ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë lokale. Gjithashtu, përfaqësimi i aktorëve lokalë në platformat ekzistuese të konsultimit në nivel kombëtar nuk është praktikë e zakonshme. As KEK, as KT nuk ka ndonjë përfaqësim lokal në bord për të qenë zëri i këtij grupi të synuar. Ky nuk është rasti i KI që ka në mesin e anëtarëve të saj Ministrin e Pushtetit Lokal.	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Autoritetet lokale duhet të japin shembuj pozitive të konsultimeve që ndodhin në nivel ndërkombëtar dhe të japin ide e më pas të krijojnë platforma konkrete për të kryer konsultime në nivel lokal. Një mundësi është që ata të kërkojnë asistencë teknike nga homologët e tyre të huaj për kryerjen e konsultimeve dhe për të qenë sa më transparent me komunitetin lokal;	Qeverisja lokale
		Autoritetet lokale duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në platformat ekzistuese në nivel kombëtar.	Të gjitha platformat
<b>E. Mungesa e transparencës në platformat ekzistuese</b>	KEK institucionalizoi më tej dialogun publik-privat. Për një komunikim sa më eficient të vazhdueshëm dhe të shpejtë, Sekretariati i KEK ka ndërtuar dhe menaxhon faqen web të KEK ku anëtarët mund të japin ide, feedback, propozime dhe rekomandime. Megjithëse angazhimi i	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Këto platforma dhe ministritë përkatëse duhet të publikojnë dokumentet që shoqërojnë aktet normative gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe adaptimit (Tabela e divergjencave, rekomandimet dhe opinionet në çdo fazë të procesit të vendim-marrjes dhe termat e	Të gjitha platformat dhe Ministrinë e Linjës

	<p>palëve të interesit realizohet nëpërmjet <i>ndërveprimit në faqen web të KEK</i>, nga një vizitë në këtë faqe shihet qartë se <i>informacioni që ndodhet aty është i cekët, i pjesshëm dhe i pa-azhurnuar</i>. Palët e interesit duke përfshirë edhe shoqatat e biznesit duhet të njoftohen rreth shqyrtimeve të KEK dhe ministrisë përkatëse nuk i publikojnë në faqen e tyre të internetit as nuk i shpërndajnë në mënyra të tjera rezymetë apo përmbledhjet e rekomandimeve të marra nga komuniteti i biznesit</p>	botimit);	
		Duhet që të publikohen të gjitha rekomandimet e marra nga komuniteti i biznesit dhe pozicionin e institucioneve publike, pranimin apo refuzimin e tyre shoqëruar me argumentet përkatëse;	Të gjitha platformat dhe Ministrinë e Linjës
		Duhet të ketë më shumë mundësi për përfshirjen e SME-ve në informimin dhe vendimmarrjen në çështjet ekonomike.	Të gjitha platformat
<p><b>F. Mungesa e kapaciteteve teknike të sekretariateve përfaqësuese të platformave ekzistuese</b></p>	<p>Sekretariatet teknike të platformave ekzistuese të dialogut publik-privat luajnë një rol të rëndësishëm në procesin konsultues sepse ata merren me monitorimin e progresit të takimit dhe me rekomandimet e adresuara nga takimet, prandaj ata duhet të ndjekin edhe mundësinë e zbatimit ose jo të këtyre rekomandimeve dhe mundësinë që ato kanë për t'u përfshirë në draftet e hartuara nga politikbërësit. Por jo të gjitha platformat i kanë këto kapacitete.</p>	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Është e rëndësishme të ketë një staf më të madh në numër dhe një ndarje të qartë të detyrave, të tilla si: koordinimi online i konsultimeve, monitorimi i kërkesave dhe rekomandimeve që rrjedhin nga mbledhjet e KEK dhe nga të gjitha forumet online, organizimi i takimeve të KEK, organizimi i analizave etj.	KEK, KT
		Stafi mund të rekrutohet duke marrë në konsideratë të gjitha aftësitë teknike;	Të gjitha platformat
		KEK duhet të ngrejë një zyrë ankesash në mënyrë që ti delegojë asaj përgjegjësinë e sekretariatit teknik ndaj ankesave.	KEK
<p><b>G. Mungesa e implementimit efektiv të ligjit mbi “ njoftimin dhe konsultimin publik”</b></p>	<p>Pavarësisht kuadrit ligjor të përshtatshëm dhe strukturave të krijuara, bizneset kanë shprehur pakënaqësi lidhur me informacionet paraprake. Sipas shqetësimeve të shprehura në forume të ndryshme, ligjet mbi konsultimin dhe transparencën shpesh nuk janë respektuar siç duhen. Pavarësisht se janë informuar, ky informacion vjen tek ta në një stad të</p>	<b>NBF rekomandon:</b>	
		Sekretariatet teknike të KI duhet të lejojnë një funksionim më të mirë të informimit paraprak të bizneseve. Ndërveprimet e vazhdueshme midis përfaqësuesve të biznesit dhe sekretariateve teknike mund të ndihmojnë më shumë në zbatimin rigoroz të ligjit dhe ushtrimin e presionit të duhur për implementimin;	Të gjitha platformat

	avancuar të reformës ose draftit, duke lënë kështu pak mundësi për bizneset të ndërveprojnë me komentet dhe rekomandimet e tyre.	Një koordinim më i mirë mes agjencive qeveritare, ministrive përkatëse dhe agjencive me institucionet e qeverisë lokale dhe sekretariatet teknike.	Sekretariatet e platformave, Ministrinë e Linjës, qeverisja lokale
--	--	--	--

## REFERENCAT

- ACER, 2016, *Raporti i Vlerësimit të Korrupsionit*, Tiranë, Shqipëri.  
[http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/CAR\\_Albania\\_2016/Raporti\\_i\\_Vlerësimit\\_te\\_Korrupsionit\\_2016.pdf](http://seldi.net/fileadmin/public/PDF/Publications/CAR_Albania_2016/Raporti_i_Vlerësimit_te_Korrupsionit_2016.pdf)
- Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2016, *Për formalizimin e bujqësisë: Skema e kompensimit të tvsh-së dhe subvencionet*. Tiranë, Shqipëri.
- Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2015, *Për formalizimin e bujqësisë: Skema e kompensimit të tvsh-së dhe subvencionet..* Tiranë, Shqipëri.
- Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2015, *Informaliteti, beteja e përbashkët qeveri - sipërmarrje*. Tiranë, Shqipëri.
- Këshilli Shqiptar i Investimeve, 2016, *Sekretariati i Këshillit të Investimeve: Dokument Pune – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve midis Biznesit dhe Administratës Publike, Mars 2016*. Tiranë, Shqipëri.  
[https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/EN\\_WP-Dispute-Resolution-26-02-2016.pdf](https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/EN_WP-Dispute-Resolution-26-02-2016.pdf)
- AMCHAM, 2016, *Indeksi i Biznesit, 2015-2016*, Tiranë, Shqipëri.  
[http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI\\_2015\\_2016\\_en.pdf](http://www.amcham.com.al/wp-content/uploads/2016/06/AmChamBI_2015_2016_en.pdf)
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, 2015, *Raport Vjetor, Kapitulli IV, Pika 4.2.1*, Tiranë, Shqipëri.
- Qendra Ndërkombëtare për Sipërmarrje Private, 2011, *Axhenda Kombëtare e Biznesit për Afganistanin*
- Komisioni Evropian, 2016, *Progres Raporti 2016*, Bruksel, BE.  
[http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](http://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)
- Ministria e Financës, 2016, *Faza e dytë e luftës kundër informalitetit*, Tiranë, Shqipëri.  
<http://www.financa.gov.al/al/newsroom/lajme/aksioni-kunder-informalitetit-prezantohet-faza-e-dyte&page=3>
- Forumi Kombëtar i Biznesit, 2016, *‘‘Problematikat e zbatimit të kontrollit tatimor tek bizneset private në Shqipëri’’*, Tiranë, Shqipëri.  
[http://www.nbf.al/images/Implementation\\_Gaps\\_in\\_Tax\\_Inspections\\_of\\_Private\\_Businesses\\_in\\_Albania.pdf](http://www.nbf.al/images/Implementation_Gaps_in_Tax_Inspections_of_Private_Businesses_in_Albania.pdf)

- Forumi Kombëtar i Biznesit, 2016, *Raporti i Monitorimit të kontrollit tatimor në Shqipëri 2014-2016*, Tiranë, Shqipëri.  
[http://www.nbf.al/images/FINAL\\_tax\\_inspection\\_monitoring\\_report\\_NBF\\_May\\_2.pdf](http://www.nbf.al/images/FINAL_tax_inspection_monitoring_report_NBF_May_2.pdf)
- Forumi Kombëtar i Biznesit, 2016, *Këndvështrimi i forumit kombëtar të biznesit (nbf) mbi çështjen e informalitetit në Shqipëri*, Tiranë, Shqipëri.  
[http://www.nbf.al/images/NBF\\_perspectives\\_on\\_informality\\_in\\_Albania\\_NBF\\_2016.pdf](http://www.nbf.al/images/NBF_perspectives_on_informality_in_Albania_NBF_2016.pdf)
- Axfenda Kombëtare e Biznesit, 2012, *Raporti i monitorimit të Axfendës Kombëtare të Biznesit*, Moldova.
- Schneider, Friedrich, 2012, *Vlera e shtuar e aktiviteteve të fshehura: Madhësia dhe Matja e Ekonomive së fshehtë në 110 vende në të gjithë botën*, Johannes Kepler University Linz, AT.  
<http://ftp.iza.org/dp6423.pdf>
- Federata Evropiane e Konsulencës Bujqësore, 2009, *TVSH: regjime specifike*.  
Link: <http://www.efac.net/?p=90>
- Statistika mujore:  
<http://www.financa.gov.al/al/raportime/programimi-ekonomiko-fiskal/raporte-dhe-statistika-fiskale-mujore/statistika-fiskale-mujore>